

MODUL TRAJNIMI PER MESUESIT MBI PARANDALIMIN E TRAFIKIMIT

Ky modul eshte zhvilluar ne kuadrin e Projektit Rajonal te Edukimit te IOM mbi:
Parandalimin e Trafikimit te Qenieve Njerezore ne territorin e Ballkanit Perendimor
Nepermjet Aktiviteteve Edukative dhe Ngritjes se Kapaciteteve ne shkolla ne:

**Shqiperi, Bosnje & Herzegovine, Kroaci, Kosove (province e Serbise dhe Malit te
Zi), Ish Republika Jugosllave e Maqedonise dhe ne Serbi – Mali I Zi**

Pergatitur nga:

Instituti i Kurrikulave dhe Standarteve ne Shqiperi
Robert Gjedia

dhe

Organizata Nderkombetare per Migracionin - IOM
Ruth Rosenberg
Anna Bengtsson
Silvana Haxhiaj

TIRANE, SHQIPERI
GUSHT 2005

Me mbeshtetjen Financiare te Ministrise se Puneve te Jashteme te Hollandes



Ky modul eshte zhvilluar ne kuadrin e Projektit Rajonal te Edukimit te IOM mbi: Parandalimin e Trafikimit te Qenieve Njerezore ne territorin e Ballkanit Perendimor, nepermjet aktiviteteve edukative dhe ngritjes se kapaciteteve ne shkolla ne: Shqiperi, Bosnje & Herzegovine, Kroaci, Kosove (provinca e Serbise dhe Malit te Zi), Ish Republika Jugosllave e Maqedonise dhe ne Serbi – Mali i Zi

Ky Module eshte pergatitur nga Instituti i Kurrikulave dhe Standarteve, Ministria e Arsimit dhe Shkencave te Shqiperise ne bashkepunim me misionin e IOM ne Tirane dhe u be i mundur nepermjet mbeshtetjes financiare te Minsitrise se Puneve te Jashteme te Holandes.

© IOM Tirana, 2005. Te gjitha te drejtat jane te rezervuara. Permbajtje apo pjese te ketij botimi mund te perdoren dhe te kopjohen lirisht vetem per qellime edukative dhe jo komerciale, duke patur parasysh qe IOM-Tirana, te njihet si burim i autoresise per cdo reference ne lidhje me te.

Trainim i IOM për Luftën kundër Trafikimit Pyetësor para trainues



Faleminderit për kohën që i kushtuat plotësimin të këtij pyetësi. Ju lutemi, jeni të lirë të shënoni më shumë se një përgjigje aty ku e gjykonin të nevojshme, si edhe të bëni komente. Opinione tuaja do të na ndihmojnë për të përmirësuar trainimin e ardhshëm. *Gjithë informacioni do të mbetet konfidencial.*

Informacion personal:

Gjinia	Mosha	Niveli arsimor
<input type="checkbox"/> Mashkull	<input type="checkbox"/> 18-25	<input type="checkbox"/> Fillestar
<input type="checkbox"/> Femër	<input type="checkbox"/> 26-40	<input type="checkbox"/> Sekondar
	<input type="checkbox"/> 41-55	<input type="checkbox"/> Arsim profesional
	<input type="checkbox"/> 56-65	<input type="checkbox"/> Niveli i arsimit profesional
	<input type="checkbox"/> 65+	<input type="checkbox"/> Diplomë universiteti
		<input type="checkbox"/> Master
		<input type="checkbox"/> Doktoraturë

Punësimi

- Mësues në shkollë të mesme
- Mësues në nivelin arsimor sekondar
- Mësues në nivelin arsimor fillestar
- Tjetër: _____

- 1) Nëse jeni mësues, çfarë lënde (lëndësh) jepni mësim aktualisht?
- 2) A keni marrë pjesë ndonjëherë në trainime mbi trafikimin e qenieve njerzore?
 - Po
 - JoNëse po, ju lutemi përshkruani:
- 3) A keni dëgjuar ndonjëherë për trafikimin e qenieve njerzore (në televizion, në gazeta, nga miqtë apo shokët)?
 - Po
 - Jo
 - Ndoshta/Nuk jam i sigurt
- 4) Cila përgjigje përfshin grupin e elementëve, të cilët duhet të jenë të pranishëm në mënyrë që një situatë e caktuar të kategorizohet si trafikim i qenieve njerzore? **Zgjidhni vetëm një përgjigje**
 - Emigrimi ndërkombëtar; prostituimi; detyrimi, mashtrimi apo abuzimi me pushtetin
 - Emigrimi ndërkombëtar; shfrytëzimi; detyrimi, mashtrimi apo abuzimi me pushtetin
 - Emigrimi ndërkombëtar; shfrytëzimi
 - Rekrutimi/emigrimi i ndihmuar; shfrytëzimi; detyrimi, mashtrimi apo abuzimi me pushtetin
 - Rekrutimi/emigrimi i ndihmuar; prostituimi; detyrimi, mashtrimi apo abuzimi me pushtetin
 - Emigrimi i paligjshëm; prostituimi; detyrimi, mashtrimi apo abuzimi me pushtetin
 - Emigrimi i paligjshëm; shfrytëzimi; detyrimi, mashtrimi apo abuzimi me pushtetin
 - Emigrimi i paligjshëm; shfrytëzimi

- 5) Cili prej pohimeve të mëposhtme e përshkruan më mire ndryshimin midis trafikimit të qenieve njerëzore dhe kontrabandës së emigrantëve? **Zgjidhni vetëm një përgjigje**
- Trafikimi dhe kontrabanda janë e njëjta gjë.
 - Kontrabanda përfshin ndihmën për të hyrë ilegalisht në një Shtet të caktuar. Trafikimi mund ose mund të mos e përfshijë hyrjen ilegale në një Shtet të caktuar, por rezulton edhe në shfrytëzim seksual ose në shfrytëzim të punës nëpërmjet forces, mashtrimit ose abuzimit me pushtetin.
 - Kontrabanda përfshin detyrimin e njerëzve për të punuar në kushte shfrytëzuese në vende të huaja. Trafikimi përfshin detyrimin e grave për të punuar si prostituta në vende të huaja.
- 6) A mendoni se vendi juaj është i prekur nga trafikimi i qenieve njerëzore?
- Po, së tepërmi
 - Në njëfarë mase
 - Aspak
 - Nuk e di
- 7) A mendoni që shkolla luan një rol në parandalimin e trafikimit?
- Po
 - Jo
- 8) Nëse po, ju lutemi përshkruani rolin që luan shkolla në parandalimin e trafikimit
- 9) A mund të përfshihet parandalimi i trafikimit në lëndët që jepni mësim?
- Po
 - Jo
- 10) Nëse po, ju lutemi përshkruani shkurtimisht mënyrën e përfshirjes së parandalimit të trafikimit në lëndën që jepni mësim.

Pyetje lidhur me studimin e rasteve:

- 11) Daniela është një vajzë 14 vjeçare të cilën halla/tezja e ka dërguar për të punuar gjatë verës në një fabrikë në një shtet të huaj. Ajo merr pagesat për punën që kryen Daniela nga burri që e ka rekrutuar atë dhe Daniela është e lumtur që ndihmon familjen. A është Daniela viktimë e trafikimit?
- Po
 - Jo

Shpjegoni përsenë për secilën nga përgjigjet:

12) Pa ndihmën e askujt, Andrew hyri ilegalisht në një shtet tjetër për të punuar në ndërtim. Puna është shumë e rrezikshme, kushtet e jetesës janë shumë të këqija dhe ai në më të shumtën e rasteve punon 15 orë në ditë dhe paguhet shumë pak. Ndonëse Andrew nuk është i lumtur, ai vendos të qëndrojë pasi fiton më tepër nga sa mund të fitonte në vendin e tij. A është Andrew i trafikuar apo i kontrabanduar?

- I Kontrabanduar
- I trafikuar
- Të dyja së bashku
- Asnjëra

Ju lutemi, shpjegoni përgjigjen tuaj:

13) Maria vendosi të pranonte të punonte si prostitutë në një shtet tjetër. Ajo hyri në atë shtet nëpërmjet kontrabandës dhe më pas u detyrua të punonte nën kërcënimin për dhunë. Asaj ju muarën të gjitha dokumentet dhe të gjitha të ardhurat i kalonin punëdhënësit të saj? A është Maria viktimë e trafikimit?

- Po
- Jo

Shpjegoni përsenë për secilën nga përgjigjet:

14) Jacob vendosi ta linte shtëpinë për të kërkuar punë pasi kishte shqetësimin se nuk fitonte para të mjaftueshme për të paguar shkollimin e fëmijëve të tij. Një burrë nga qyteti ku jetonte i ofroi ndihmë për ta futur ilegalisht në një shtet tjetër. Sapo kaloi kufirin, ai gjeti punë në një fabrikë aty pranë. Pasi disa javësh, një burrë me të cilin punonte i foli Jacob për një punë më të mirë në qytet. Jacob i dha këtij burri të gjitha kursimet e tij dhe një natë ata udhëtuan me kamion për në një fabrikë që ishte e lidhur me fjetoren ku do të jetonte Jacob. Pasi u takua me punëdhënësin, Jacob i dorëzoi këtij të fundit të gjitha dokumentet e udhëtimit në mënyrë që ata t'i jepnin lejen e punës. Atij i thanë se punëdhënësi do t'i zbriste nga rroga shpenzimet e qëndrimit dhe ushqimit. Kur Jacob u përpoq të dilte jashtë një mbrëmje për të gjetur një telefon për të njoftuar familjen se ai ishte mire, një burrë me armë në dorë i tha se punëtorët nuk lejoheshin të dilnin. Atë e kërcënuan se do ta kthenin në vendin e tij dhe se familja e tij mund të dëmtohej nëse ai shkaktonte ndonjë shqetësim. A ishte Jacob i kontrabanduar, trafikuar apo të dyja së bashku?

- I kontrabanduar
- I trafikuar
- Të dyja së bashku
- Asnjëra

Ju lutemi, shpjegoni përgjigjen tuaj:

Faleminderit! Ne e vlerësojmë pjesëmarrjen tuaj!



Trafikimi eshte:

Rekrutimi, transportimi, trasferimi, strehimi ose mbajtja e personave me ane te kercentimit ose perdorimit te forces, apo formave te tjera te shterngimit, rrembimit, mashtrimit, pandershmerise, te abuzimit me pushtetin ose me poziten e vulnerabilitetit apo te dhenies ose marrjes se pagesave ose perfitimeve per te arritur pelqimin e nje personi per te kontrolluar nje tjeter, me qellim shtrytezimin.

(2000 KB Protokolli per Parandalimin, Ndalimin dhe Ndeshkimin e Trafikimit ne Njerez, veçanerisht ne gra dhe femije; Plotesues i Konventes se KB mbi Krimin Transkombetare)



Trafikimi i Grave dhe Femijeve eshte:

Largimi i grave dhe femijve nga ambjenti familjar ose nga sisteme te tjera mbeshtesese me ane te:

Procesi	+	Rruge/Menyra	+	Qellimi
Rekrutimi	D	Kercenim	D	
Ose	H	Ose	H	Prostitucioni
Transportimi	E	Shterngim	E	Ose
Ose		Ose		Pornografia
Transferimi		Rrembim		Ose
Ose		Ose		Dhuna/Shfrytezimi Seksual
Strehimi		Mashtrim		Ose
Ose		Ose		Puna e Detyruar/me rroga
Mbajtja		Genjim		with te parsyeshme
		Ose		Ose
		Pandershmeri		Sklaveri/Praktika te ngjashme
		Ose		
		Abuzim me Pushtetin		

1 + 1 + 1

Perjashtim per Femijet – ne rastin e nje personi nen 18 vjeç, nje rruge/menyre nuk eshte e nevojshme-vetem nje process dhe nje qellim. Femijet nuk mund te japim pelqim per shfrytezimin e tyre.

Pelqimi viktimes nuk merret parasysh kur nje nga rruget apo menytrat e mesiperme eshte perdorur.

*) Strukture e ACILS/ICMC mbi Trafikimin e Grave dhe Femijve



PERKUFIZIME¹

Puna e detyruar (gjithashtu a njohur si **vartesi borxhi**) ndodh kur puna e nje personi kerkohet si mjet i ripagimit te nje huaje.

Puna e femijve eshte fenomeni i femijve te punesuar. Ne shume vende, konsiderohet e papershtatshme ose shfrytezuese ne se nje femije nen nje moshe te caktuar pune, punon, me perjashtim te disa puneve te vogla shtepiake dhe pa dyshim te punes shkollore. Nje punedhenes, shpesh, nuk lejohet te punesoje nje femije, i cili eshte nen nje moshe te caktuar. Kufiri i moshes minimale varet nga vendi (*Burimi: Fjalor. LaborLawTalk.com*).

Shfrytezimi eshte akti i perfitimit ndaj dikujt, ne vecanti akti i perfitimit padrejtesisht ndaj nje personi tjeter me qellim perfitimi personal (*Burimi: Black`s Law Dictionary*).

Puna e Detyruar: Marrja e punes apo sherbimeve nga individet nepermjet dhunes apo kercenimit per dhune, abuzimit me autoritetin apo me poziten dominante, zgjedhen e borxhit, mashtrimit apo formave te tjera te shtrengimit. Puna e detyruar mund te jete ne perfitim te qeverive, individeve privat, kompanive apo shoqatave (*Burimi: Wijers and Lap-Cew*).

Shfrytezimi i Punes– Te perfitosh nga puna e te tjereve pa dhene nje shperblim te drejte (d.m.th respektimi i pages minimale, kushteve te arsyeshme te punes, standarteve te pranuar te punes etj).

Migrant – Migrant eshte individi qe largohet nga vendi i tij/saj i origjines per motive politike, ekonomike, sociale, fetare apo per arsye te tjera. Ekzistojne lloje te ndryshme te levizjeve-legale dhe ilegale, urbane dhe rurale, nderkombetare dhe te brendshme. **Migrant i paligjshem** eshte individi qe migron pa autoritetin ligjor per ta bere kete gje (qe do te thote pa dokumentacionin e pershtatshem).

Migrim: levizja nga nje shtet, vend, apo vendndodhje ne nje tjeter

Emigrim: lenia e nje vendi ose shteti residence per te jetuar diku tjeter

Imigrim: ardhja ne nje vend, i cili nuk eshte vendi i lindjes per sa i perket residences se perhershme

(*Burimi:Merriam-Webster Online Dictionary*)

Prostitution –Praktika e perfshirjes ne nje aktivitet seksual relativisht jodiskriminues, ne pergjithesi me individe qe nuk jane bashkeshorti/ja ose shoku/shoqja, ne shkembim te pageses se menjehershme ne para ose vlera te tjera.

(*Burimi: Encyclopedia Britannica Online*)

Shfrytezimi Seksual: Shfrytezimi seksual eshte te perfituarit padrejtesisht mbi dike, duke e perfshire ne seks ose aktivitete seksuale, si prostitucioni, pornografia, kercimi egzotik, seksurizem, martese e detyruar, e te tjera akte si keto.

¹ Disa perkufizime te perfshira ketu jane marre nga ICMC (2003) and IOM (2005) – shih see Resources at end of module for full details.

Sesioni 1: Çfare eshte Trafikimi i Qenieve Njerezore

Fletepune 3, Faqe 2

Ngacmimi Seksual: Vemendje e padesheruar nga nje person, i cili e di ose duhet mjaftueshmerisht ta dije qe nje vemendje e tille eshte e padeshirueshme; ose ne menyre te terthorte apo te shprehur premtan te kompensoje, kundrejt plotesimit te nje kerkese te orientuar seksualisht: ose te nje marredhenieje seksuale e cila perben abuzim te pushtetit gjate nje marredhenie besimi; apo komente e menyra sjelljeje te orientuara seksualisht te cilat me te drejte mund te perceptohen si fatore negative ne kushtet psikologjike dhe emocionale te punes dhe studimit. (*Burimi: Universiteti i Otaves*)

Sklaveria - Pronesia e nje individi ndaj nje individi tjeter. **Sklaveria seksuale** eshte rasti kur nje individ disponon individe te tjere dhe i perdor ata per veprimtari seksuale.

Kontrabanda– Lehtesimi i hyrjes ilegale te nje individi ne shtete ne te cilat ai nuk eshte as nenshtetas dhe as resident i perhershem me qellim perfitimin ne menyre direkte ose indirekte te te mirave materiale apo financiare. (*Perkufizimi nga Protokolli kunder Kontrabandes se Migrantëve nga Toka, Ajri dhe Deti, si shtojce e Konventes se Kombeve te Bashkuara kunder Krimin te Organizuar Transkombetar*).



Skenarët e rasteve

Studimi i rastit 1

Zana është një vajzë shqiptare 12 vjeçare nga fshati, të cilën një mik i familjes e ka çuar në qytet për të gjetur punë për të mbështetur familjen e saj. Miku i familjes e nxjerr atë në rrugët e qytetit ku ajo detyrohet të lypë nën kontrollin e tij. Disa prej fitimeve të saj i dërgohen familjes; pjesën tjetër të të ardhurave e mban miku i familjes, ashtu sikurse ishte rënë dakord me prindërit.

Studimi i rastit 2

Ira është një vajzë 21 vjeçare nga Moldavia. Ajo është e vetme dhe ka një djalë 4 vjeç. Burri e la kur lindi fëmija. Familja e saj është në pamundësi për ta mbështetur atë dhe fëmijën e saj. Ira punonte, por paga e saj nuk mjaftonte për të paguar të gjitha shpenzimet, madje pagat e fundit as nuk i ishin dhënë. Shumë gra të reja nga qyteti i saj shkonin për të punuar në vende të tjera dhe Ira mendoi se duke punuar në një shtet tjetër ajo do të kishte shansin të fitonte një sasi parash. Një grua nga qyteti i saj i premtoi se do t'i rregullonte udhëtimin dhe dokumentet dhe do t'i gjente punë si pastruese apo kamariere. Ajo e prezantoi me një burrë që do ta shoqëronte për në Itali. Sapo mbërritën atje, burri i tha Irës se ai e kishte blerë atë nga gruaja në qytet. Që nga ai moment e në vazhdim ajo u ble dhe u shit dorë më dorë dhe u zhvendos nga apartamentet në shtëpi dhe hotele, duke kaluar kufij të në mënyrë të paligjshme. Ajo përfundoi në një lokal në Kosovë, e mbyllur brenda së bashku me vajza të tjera. Ajo ishte rrahur dhe përdhunuar disa herë dhe ishte detyruar të prostituonte. Ajo nuk ishte paguar kurrë.

(E përshtatur nga Raporti i IOM për situatën në Kosovë – Shkurt 2000 deri në Shtator 2002. Mund të gjendet në: http://www.iom.int/en/PDF_Files/Other/human_trafficking_kosovo.pdf, 22-08-2005).

Studimi i rastit 3

Rea është një grua e re 25 vjeçare e divorcuar nga një fshat në afërsi të Veleshtës në Maqedoni. Ajo nuk kishte punë dhe shtëpi, dhe fëmijët janë ende në moshë të vogël. Ajo jeton e vetme në një kasolle dhe nuk ka asnjë ushqim për fëmijët e saj. Ajo filloi të lypete nëpër rrugë dhe t'u kërkonte njerëzve ndihmë. Më së fundi, asaj i ofrohet një punë si kamariere nga pronari i një bar – restoranti. Orët e punës duhet të ishin nga mbasditja deri vonë në darkë. Pronari i lokalit i kërkoi të jepte edhe shërbime seksuale për klientët. Ajo pranoi duke qenë se kishte një nevojë të dëshpëruar për para për të mbajtur fëmijët e saj. Ajo merr një rrogë prej (60 USD/muaj), si edhe bakshishet që i japin klientët.

Studimi i rastit 4

Liljana është një vajzë 20 vjeçare nga Serbia. Asaj i ofruan një punë si striptiste në një lokal në Greqi. Ajo nënshkroi kontratën dhe në Greqi një agjent mundësoi punësimin e saj në një klub nate. Kushtet e punës janë ekzaktësisht sikurse i kishin premtuar dhe ajo paguhet rregullisht.

Studimi i rastit 5

Ali, një djalë 19 vjeçar nga Bosnja, dëshironte të emigronte në Itali për të punuar në mënyrë që të ndihmonte familjen. Një shok i tij i realizoi një kontakt me një burrë (Zoti X), i cili rregulloi gjithë dokumentet e nevojshme dhe udhëtimin për në Itali. Ai i dha Alit një pasaportë falso dhe Ali u transportua ilegalisht në Itali së bashku me një grup prej 6 personash (të cilët ai nuk i njihte). Secili prej emigrantëve ilegal i detyrohej Zotit X, i cili mundësoi punën dhe lëvizjen ilegale, rreth 3000 Euro. Sapo mbërritën në Itali, Ali dhe 6 emigrantët e tjerë u dërguan të punonin në një fabrikë këpucësh. Ali punonte pothuajse 12 orë në ditë dhe ai pranoi të mos e merrte pagën e 3 muajve të parë për të shlyer borxhet që i kishte Zotit X. Pronari e pagoi rrogën e Ali direkt të Zotit X. Pronari i fabrikës i garantonte punëtorëve vetëm një vakt ushqimi në ditë dhe akomodim në një depo brenda fabrikës. Së fundi, Ali punoi 9 muaj në këtë fabrikë dhe nuk u pagua asnjëherë. Punëdhënësi refuzoi t'i jepte rrogën edhe pasi ishin shlyer borxhet e tij. Ai kishte gjithmonë një justifikim dhe i thoshte Ali se do ta paguante muajin tjetër. Ali kishte frikë të protestonte duke qene se kishte hyrë dhe qëndronte ilegalisht në Itali.



Skenarët e rasteve së bashku me përgjigjet

Studimi i rastit 1

Zana është një vajzë shqiptare 12 vjeçare nga fshati, të cilën një mik i familjes e ka çuar në qytet për të gjetur punë për të mbështetur familjen e saj. Miku i familjes e nxjerr atë në rrugët e qytetit ku ajo detyrohet të lypë nën kontrollin e tij. Disa prej fitimeve të saj i dërgohen familjes; pjesën tjetër të të ardhurave e mban miku i familjes, ashtu sikurse ishte rënë dakord me prindërit.

⇒ *Ky rast është trafikim. Zana është një fëmijë i larguar nga rrjeti i saj mbështetës, është transportuar në qytet (Procesi), vuan abuzimin e pushtetit nga familja e saj dhe miku i familjes (Mjetet) dhe është në kushtet e punës së detyruar (Qëllimi). Gjithashtu, ky është edhe një rast i punës së fëmijëve.*

Studimi i rastit 2

Ira është një vajzë 21 vjeçare nga Moldavia. Ajo është e vetme dhe ka një djalë 4 vjeç. Burri e la kur lindi fëmija. Familja e saj është në pamundësi për ta mbështetur atë dhe fëmijën e saj. Ira punonte, por paga e saj nuk mjaftonte për të paguar të gjitha shpenzimet, madje pagat e fundit as nuk i ishin dhënë. Shumë gra të reja nga qyteti i saj shkonin për të punuar në vende të tjera dhe Ira mendoi se duke punuar në një shtet tjetër ajo do të kishte shansin të fitonte një sasi parash. Një grua nga qyteti i saj i premtoi se do t'i rregullonte udhëtimin dhe dokumentet dhe do t'i gjente punë si pastuese apo kamariere. Ajo e prezantoi me një burrë që do ta shoqëronte për në Itali. Sapo mbërritën atje, burri i tha Irës se ai e kishte blerë atë nga gruaja në qytet. Që nga ai moment e në vazhdim ajo u ble dhe u shit dorë më dorë dhe u zhvendos nga apartamentet në shtëpi dhe hotele, duke kaluar kufijtë në mënyrë të paligjshme. Ajo përfundoi në një lokal në Kosovë, e mbyllur brenda së bashku me vajza të tjera. Ajo ishte rrahur dhe përdhunuar disa herë dhe ishte detyruar të prostituonte. Ajo nuk ishte paguar kurrë.

(E përshtatur nga Raporti i IOM për situatën në Kosovë – Shkurt 2000 deri në Shtator 2002. Mund të gjendet në: http://www.iom.int/en/PDF_Files/Other/human_trafficking_kosovo.pdf, 22-08-2005).

⇒ *Ky rast është trafikim. Gruaja është rekrutuar, transportuar, fshehur, blerë dhe shitur (Procesi). Ajo është mashtruar, kërcënuar, abuzuar fizikisht (Mjetet), për ta shfrytëzuar atë me qëllim prostitucioni (Qëllimi).*

Studimi i rastit 3

Rea është një grua e re 25 vjeçare e divorcuar nga një fshat në afërsi të Veleshtës në Maqedoni. Ajo nuk kishte punë dhe shtëpi, dhe fëmijët janë ende në moshë të vogël. Ajo jeton e vetme në një kasolle dhe nuk ka asnjë ushqim për fëmijët e saj. Ajo filloi të lypte nëpër rrugë dhe t'u kërkonte njerëzve ndihmë. Më së fundi, asaj i ofrohet një punë si kamariere nga pronari i një bar – restoranti. Orët e punës duhet të ishin nga mbasditja deri vonë në darkë. Pronari i lokalit i kërkoi të jepte edhe shërbime seksuale për klientët. Ajo pranoi duke qenë se kishte një nevojë të dëshpëruar për para për të mbajtur fëmijët e saj. Ajo merr një rrogë prej (60 USD/muaj), si edhe bakshishet që i japin klientët.

⇒ *Ky rast nuk është trafikim. Ndonëse është rekrutuar (Procesi) dhe është shfrytëzuar seksualisht (Qëllimi), mjetet mungojnë – ajo nuk është kërcënuar, abuzuar apo shtrënguar dhe kishte mundësi të thoshte jo në çdo kohë. Gjithësesi, ky rast është shfrytëzim seksual i një personi vulnerabël. Ajo pranoi të punonte si kamariere, por duke qenë se kishte nevojë për para për të ushqyer fëmijët, ajo pranoi të jepte edhe shërbime seksuale.*

Fletëpune 5, faqe 2

Studimi i rastit 4

Liljana është një vajzë 20 vjeçare nga Serbia. Asaj i ofruan një punë si striptiste në një lokal në Greqi. Ajo nënshkroi kontratën dhe në Greqi një agjent mundësoi punësimin e saj në një klub nate. Kushtet e punës janë ekzaktësisht sikurse i kishin premtuar dhe ajo paguhet rregullisht.

⇒ *Ky rast nuk është trafikim. Ndonëse Liljana është rekrutuar (Procesi), ajo ishte e ndërgjegjshme se po emigronte për të punuar si striptiste, pra ka një qëllim. Por, duket se ajo nuk mbahet aty kundër vullnetit të saj, kështu që mjetet mungojnë. Në varësi të kushteve të punës dhe pagës, ky rast mund të jetë një rast i shfrytëzimit të punës, por kjo gjë nuk del qartë nga informacioni i paraqitur. Gjithësesi, njerëz të ndryshëm kanë pikëpamje të ndryshme për këtë gjë. Disa mund të argumentojnë se ky është shfrytëzim seksual, pasi disa njerëz mendojnë se të gjitha format e prostitucionit dhe të punës së seksit komercial janë shfrytëzuese, por megjithatë, njerëz të ndryshëm kanë pikëpamje të ndryshme.*

Studimi i rastit 5

Ali, një djalë 19 vjeçar nga Bosnja, dëshironte të emigronte në Itali për të punuar në mënyrë që të ndihmonte familjen. Një shok i tij i realizoi një kontakt me një burrë (Zoti X), i cili rregulloi gjithë dokumentet e nevojshme dhe udhëtimin për në Itali. Ai i dha Alit një pasaportë falso dhe Ali u transportua ilegalisht në Itali së bashku me një grup prej 6 personash (të cilët ai nuk i njohte). Secili prej emigrantëve ilegal i detyrohej Zotit X, i cili mundësoi punën dhe lëvizjen ilegale, rreth 3000 Euro. Sapo mbërritën në Itali, Ali dhe 6 emigrantët e tjerë u dërguan të punonin në një fabrikë këpucësh. Ali punonte pothuajse 12 orë në ditë dhe ai pranoi të mos e merrte pagën e 3 muajve të parë për të shlyer borxhet që i kishte Zotit X. Pronari e pagoi rrogën e Ali direkt të Zotit X. Pronari i fabrikës i garantonte punëtorëve vetëm një vakt ushqimi në ditë dhe akomodim në një depo brenda fabrikës. Së fundi, Ali punoi 9 muaj në këtë fabrikë dhe nuk u pagua asnjëherë. Punëdhënësi refuzoi t'i jepte rrogën edhe pasi ishin shlyer borxhet e tij. Ai kishte gjithmonë një justifikim dhe i thoshte Ali se do ta paguante muajin tjetër. Ali kishte frikë të protestonte duke qene se kishte hyrë dhe qëndronte ilegalisht në Itali.

⇒ *Ky rast nuk është trafikim. Ndonëse Ali është rekrutuar dhe transportuar (Procesi) dhe shfrytëzuar (Qëllimi), ai nuk është shtrënguar apo kërcënuar (Mjetet). Nga informacioni i paraqitur duket sikur Ali ishte i lirë të largohej në çdo kohë. Ky është një rast kontrabande me qëllim shfrytëzimin e punës. Ali dhe 6 burrat e tjerë u transferuan dhe u transportuan ilegalisht duke përdorur dokumente false. Ata i kërkuan dhe i iniciuan vetë kontaktet me kontrabandistët me vullnetin e tyre të lirë dhe ndaj tyre nuk ka patur mashtrim apo abuzim me pushtetin.*



Vështrim i përgjithshëm mbi Emigracionin Ndërkombëtar²

- Në vitin 2000, në botë ka patur 175 milion emigrantë ndërkombëtar; që do të thotë 1 në çdo 35 persona, prej të cilëve 48% ishin gra. Në fillim të vitit 2005, Departamenti i UN për Popullsinë parashikonte një total të numrit të emigrantëve që varionte nga 185 milion deri në 192 milion. (Ky numër mund të përfshijë edhe disa emigrantë të parregullt).
- Gjatë viteve të fundit, ka patur flukse të mëdha emigrantësh që pjesërisht kanë qenë rezultat i ekonomive dhe tregjeve të pabarabarta të punës, faktorëve social dhe politik, fatkeqësive natyrore, prishjes së mjedisit, rritjes së vrullshme të popullsisë, pengesave për të tregëtuar dhe investuar, si edhe konflikteve civile.
- Pjesa më e madhe e emigrantëve është e përqëndruar në një numër relativisht të vogël të vendeve me industri të zhvilluar. Nga ky kontigjent, në vitin 2000, pothuajse gjysma kanë qenë gra. Për vendet e zhvilluara, veçanërisht në Europë, Amerikën e Veriut, Azinë Lindore dhe Oqeaninë, emigracioni ofron një burim alternativ të njerëzve dhe të punës, në një kohë kur po vihet re një rënie e burimeve të punës dhe të popullsisë dhe po bëhen rivlerësime të politikave të emigracionit. Për vendet në zhvillim, kjo ndihmon në reduktimin e forces së tepërt të punës, në uljen e papunësisë dhe të numrit të personave në familje.
- Gratë dhe burrat lëvizin në mënyra të ndryshme në ekonominë globale, pra ata kanë modele të ndryshme emigrimi. Kryesisht, grate hyjnë (ose po tentohet të hyjnë) në sektorët e shërbimeve dhe asistencës sociale dhe po luajnë një rol gjithmonë e më të rëndësishëm në krijimin e familjeve dhe nxitjen e zhvillimit në disa vende të Afrikës, Azisë Juglindore dhe Azisë Jugore.
- Gratë përbëjnë pjesën më të madhe të viktimave të identifikuara të trafikimit të qenieve njerëzore në botë. Po ashtu, ato përbëjnë 70% të numrit të përafërt prej 25 milion individë të shpërngulur brenda për brenda vendit për shkak të konflikteve.
- Gjatë 35 viteve të fundit, numri i punëtorëve emigrant është dyfishuar. Ka patur zhvendosje të theksuara të poleve tërheqës për emigracionin e punës, për shembull në Azinë jugore dhe juglindore, si edhe në vendet me nivel të ulët të shtimit të popullsisë (fertiliteti), të cilët kanë një popullsi “në plakje.” Familjet e vendeve në zhvillim shpesh dërgojnë nëpër botë një pjesëtar të familjes për të përmirësuar kushtet e jetesës në vendin e tyre.
- Llojet e emigrimit po ndryshojnë me shpejtësi: Aktualisht, njerëzit po lëvizin provizorisht, duke qendruar për një kohë më të gjatë, por duke u kthyer më pas në vendin e tyre të origjinës. Mundësitë për të studiuar në vendet përtej oqeanit po zgjerohen dhe po hapin rrugët për kategori të tjera emigrantësh, të cilët do të jenë më të kualifikuar dhe do të qendrojnë për një kohë më gjatë.

² Burimi: *Emigracioni Botëror 2005. Kostot dhe përfitimet e Emigracionit Ndërkombëtar*. Organizata Ndërkombëtare për Migrimin (IOM) 2005.



Tendencat e Emigracionit në vendet e Ballkanit dhe të Europës Lindore³

- Faktorët gjeopolitik gjatë viteve '90 i kanë ndryshuar në mënyrë dramatike modelet e emigrimit në vendet e Ballkanit. Kombinimi i mungesës së stabilitetit ekonomik, konflikteve etnike, vështirësisë ekonomike dhe hapjes së kufijve që pasuan rënien e sistemit komunist në vendet e ish bllokut lindor dhe të Bashkimit Sovjetik rezultuan në një vale të emigracionit ndërkombëtar, si midis vendeve të prekura ashtu edhe prej këtyre vendeve drejt Perëndimit.
- Me ndarjen e ish Jugosllavisë, numri i emigrantëve në rajon u rrit ndjeshëm, pasi njerëzit që më parë konsideroheshin si migrant të brendshëm u kthyen në emigrantë ndërkombëtar me kalimin e kufijve të shteteve të pavarura të sapo krijuara. Konflikti i gjatë që pasoi, në mënyrë të veçantë në ish Jugosllavi, shkaktoi gjithashtu zhvendosje masive të popullsisë.
- Emigrimi ndërkombëtar midis vendeve të Europës Lindore dhe vendeve të ish Bashkimit Sovjetik vlerësohej në shifrat 1.5 milion deri në 2 milion individë për çdo vit në periudhën gjatë viteve 1990 – 1994. Gjatë po kësaj periudhe, kanë emigruar me destinacion vendet e Perëndimit rreth 1 milion individë. Në rritjen e numrit të emigrantëve ndikoi edhe ndarja e Çekosllovakisë, Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë, pasi u riadhesuan individë që i përkisnin disa prej shteteve të pavarura të sapo krijuara, por që jetonin në shtete të tjera.
- Në periudhën 1990 deri në 2000, Europa Perëndimore pati më shumë se 2 milion aplikime për azil nga qytetarë të vendeve të ish bllokut komunist. Ndarja e ish Jugosllavisë – e në mënyrë të veçantë lufta në Kroaci në vitin 1991 dhe në Bosnje & Hercegovinë në vitin 1992 – gjeneroi një rrjedhje prej afro gjysmë milioni individësh në vit për periudhën nga viti 1990 deri në vitin 1994 (UN, 2002). Një numri të vogël të aplikuesve i'u dha statusi i refugjatit dhe shumë të tjerë u lejuan të qëndronin për motive humanitare.
- Bosnja & Hercegovina, një shoqëri e dalë nga lufta, në periudhën 1 Janar 1996 – 31 Mars 2003, pati një total prej 515,435 të kthyerish në vend. Midis tyre, 401,785 individë i përkisnin grupeve minoritare.
- Gjatë luftës në Kosovë, më shumë se 70% e popullsisë së Kosovës u shpërngulën nga shtëpitë e tyre. Kjo rezultoi në qindra dhe mijëra refugjatë në periudhën pas konfliktuale në fund të '90.
- Gjatë regjimit komunist, Shqipëria ka qenë jashtëzakonisht e izoluar dhe fenomeni i emigrimit ishte pothuajse inekzistent. Pas periudhës komuniste, sidomos gjatë viteve 1991 – 1998, pothuajse 1/6 e popullsisë emigroi në shtete të tjera, pjesa më e madhe e së cilës ishin meshkuj të moshës 20 deri në 40 vjeç. Emigrantët shkuan kryesisht në Greqi dhe Itali; dhe më vonë në Mbretërinë e Bashkuar dhe Amerikën e Veriut. Aktualisht, Greqia, Italia dhe Mbretëria e Bashkuar janë streha e 94% të emigrantëve shqiptarë. Vlerësimet tregojnë se rreth gjysma e tyre nuk kanë dokumente.

³ Burimi: *Emigracioni Botëror 2005. Kostot dhe përfitimet e Emigracionit Ndërkombëtar*. Organizata Ndërkombëtare për Migrimin (IOM) 2005.



**Pjesë nga Konventa e KB për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë
punëtorëve emigrant dhe të familjeve të tyre.**

Neni 9

E drejta e jetës së punëtorëve emigrant dhe anëtarëve të familjeve të tyre mbrohet me ligj.

Neni 10

Asnjë punëtor emigrant apo anëtar i familjes së tij/saj nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës.

Neni 11

1. Asnjë punëtor emigrant apo anëtar i familjes së tij/saj nuk mund të mbahet në kushte skllavëruese apo si shërbëtor.

2. Asnjë punëtor emigrant apo anëtar i familjes së tij/saj nuk mund t'i kërkohet të kryejë punë të rënda apo të detyruara.

3. Paragrafi 2 i nenit 11 nuk përfshin rastet kur kryeja e punëve të rënda vendoset nga gjykata kompetente si plotësuese e vuajtjes së dënimit me burgim, në ato Shtetet ku burgimi i shoqëruar me kryerjen e punëve të rënda parashikohet si ndëshkim për kryerjen e një krimi.

4. Në kuptim të këtij neni, termi “punë e rëndë apo e detyruar” nuk do të përfshijë:

(a) çdo punë apo shërbim që nuk përfshihet në paragrafin 3 të këtij neni dhe që normalisht i kërkohet një personi në arrest në zbatim të një vendimi të ligjshëm të marrë nga gjykata, apo një personi të liruar me kusht nga një arrest i tillë;

(b) çdo shërbim i kërkuar në rastet e emergjencave apo katastrofave që kërcënojnë jetën ose shëndetin e komunitetit;

(c) çdo punë apo shërbim që bën pjesë në detyrimet civile normale kur këto detyrime janë vendosur edhe mbi shtetasit e tjerë të vendit në fjalë.

Neni 15

Asnjë punëtor emigrant apo anëtar i familjes së tij/saj nuk mund të privohet në mënyrë arbitrare nga prona, e zotëruar kjo në mënyrë individuale apo kolektive (së bashku me individë të tjerë). Në rastet kur sipas legjislacionit në fuqi të Shtetit punësues, asetet e një punëtor emigrant apo të një anëtar i familjes së tij/saj konfiskohen totalisht apo pjesërisht, personi në fjalë ka të drejtën e kompesimit të drejtë dhe të përshtatshëm.

Neni 16

1. Punëtorët emigrant dhe anëtarët e familjeve të tyre gëzojnë të drejtën e lirisë dhe të sigurisë së personit.

2. Punëtorët emigrant dhe anëtarët e familjeve të tyre gëzojnë të drejtën e mbrojtjes efektive nga Shteti kundër dhunës, dëmtimit fizik, kërcënimit apo frikësimit, të ushtruar nga nëpunësit publik apo individët privat, grupet apo institucionet.

3. Çdo verifikim nga nëpunësit e zbatimit të ligjit për identitetin e punëtoreve emigrant apo anëtarëve të familjeve të tyre duhet të bëhet në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj.

4. Punëtorët emigrant dhe anëtarët e familjeve të tyre nuk mund t'i nënshtrohen kolektivisht apo individualisht arrestit apo ndalimit arbitrar; ata nuk mund të privohen nga liria e tyre përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj.

5. Punëtorët emigrant dhe anëtarët e familjeve të tyre që arrestohen do të informohen në kohën e arrestimit, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në gjuhën që ata kuptojnë, për arsyet e kësaj mase dhe për akuzat e ngritura kundër tyre.

6. Punëtorët emigrant dhe anëtarët e familjeve të tyre që arrestohen apo ndalohen me akuzën e kryerjes së një veprë penale duhet të dërgohen menjëherë para gjyqtarit apo punonjësit të autorizuar me ligj për ushtrimin e kompetencave gjyqësore dhe duhet të gjykojnë brenda një kohe të arsyeshme apo të lirohen. Mbajtja e tyre në paraburgim në pritje të zhvillimit të gjyqit nuk duhet të jetë rregull i përgjithshëm, por lirimi kërkon garanci të caktuara që lidhen me paraqitjen në gjyq, paraqitjen në çdo fazë të procedimeve gjyqësore dhe, nëse është rasti, edhe paraqitja për ekzekutimin e vendimit.

7. Në rastet kur një punëtor emigrant apo një anëtar i familjes së tij/saj arrestohet apo i nënshtrohet burgimit apo paraburgimit në pritje të zhvillimit të gjyqit, apo mbahet në ndonjë mënyrë tjetër:

(a) Konsulli apo autoritetet diplomatike të Shtetit të tij/saj të origjinës apo të një Shteti tjetër që përfaqëson interesat e këtij Shteti, duhet të informohen pa vonesa lidhur me arrestin apo ndalimin, si edhe mbi arsyet e marrjes së kësaj mase nëse kjo gjë kërkohet nga punëtori emigrant apo anëtar i familjes së tij/saj;

(b) Personi në fjalë ka të drejtë të komunikojë me autoritetet e sipërpërmendura. Çdo korrespondencë e personit në fjalë me këto autoritete duhet të dërgohet pa asnjë vonese dhe ai/ajo kanë të drejtën të marrin pa asnjë vonesë komunikimet e dërguara nga autoritetet e lartpërmendura;

(c) Personi në fjalë duhet të informohet menjëherë për këtë të drejtë dhe për të drejta të tjera që rrjedhin nga marrëveshjet përkatëse nëse ka ndonjë të tillë të nënshkruar nga Shtetet përkatëse, të komunikojë dhe të takohet me përfaqësuesit e autoriteteve të lartpërmendura dhe të përgatisë së bashku me ta përfaqësimin ligjor të tij/saj.

8. Punëtorët emigrant dhe anëtarët e familjeve të tyre që privohen nga liria nëpërmjet arrestimit apo ndalimit duhet të kenë të drejtën e paraqitjes para gjykatës, në mënyrë që gjykata të vendosë pa vonesa për ligjshmërinë e ndalimit së tyre dhe të lëshojë urdhërin për lirimin e tyre nëse ndalimi nuk është i ligjshëm. Gjatë marrjes pjesë në këto procedime, ata duhet të kenë asistencë dhe, nëse nuk e kuptojnë apo nuk e flasin gjuhën e përdorur, duhet të kenë një përkthyes pa shpenzimet e tyre.

9. Punëtorët emigrant dhe anëtarët e familjeve të tyre që kanë qenë viktimat të arrestimit apo ndalimit të paligjshëm duhet të kenë të drejtën e kompesimit.

Neni 22

1. Punëtorët emigrant dhe anëtarët e familjeve të tyre nuk duhet t'i nënshtrohen masave të dëbimit kolektiv. Çdo rast dëbimi duhet të shqyrtohet dhe të vendoset individualisht.

2. Punëtorët emigrant dhe anëtarët e familjeve të tyre mund të dëbohen nga territori i një Shteti vetëm në bazë të një vendimi të marrë nga organi kompetent dhe në përputhje me ligjin.

3. Vendimi komunikohet në gjuhën që ata kuptojnë. Me kërkesën e tyre dhe në rastet kur nuk kërkohet të veprohet ndryshe, vendimi komunikohet edhe me shkrim së bashku me arsyet për marrjen e këtij vendimi, me përjashtim të rasteve të veçanta kur kjo gje nuk mund të bëhet për mbrojtjen e sigurisë kombëtare. Personat e interesuar duhet të njoftohen për këto të drejta para ose të paktën gjatë kohës së marrjes së vendimit.

4. Me përjashtim të rasteve kur vendimi shpallet nga një organ gjyqësor, personat e interesuar duhet të kenë të drejtën e paraqitjes së motiveve se përse ai/ajo nuk duhet të dëbohen nga vendi, si edhe të drejtën që çështja e tyre të shqyrtohet nga një organ kompetent, në qoftë se nuk kërkohet të veprohet ndryshe për shkak të sigurisë kombëtare. Gjatë kohës kur bëhet ky shqyrtim, personat e interesuar kanë të drejtë të kërkojnë shtyrjen e vendimit të dëbimit nga vendi.

5. Nëse një vendim dëbimi që është ekzekutuar anulohet, personi i interesuar ka të drejtë të kërkojë kompesim sipas ligjit dhe vendimi i mëparshëm nuk duhet të përdoret për ta penguar këtë person që të rihyjë në Shtetin në fjalë.

6. Në rast dëbimi, personit të interesuar duhet t'i jepet një mundësi e përshtatshme para ose pas nisjes për të zgjidhur çdo pretendim lidhur me pagat dhe përfitimet e tjera që i takojnë, si edhe për çdo përgjegjësi tjetër të mbetur pezull.

7. Pa u ndikuar nga ekzekutimi i vendimit për dëbim, punëtorët emigrant dhe anëtarët e familjeve të tyre që kanë qenë subjekte të një vendimi të tillë, mund të kërkojnë të hyjnë në një Shtet tjetër dhe jo në Shtetin e tyre të origjinës.

8. Në rastet e dëbimit të punëtorëve emigrant apo anëtarëve të familjeve të tyre, shpenzimet e dëbimit nuk do të mbulohen prej tyre. Personit në fjalë mund t'i kërkohet të paguajë për shpenzimet e udhëtimit.

9. Dëbimi nga Shteti punësues nuk do të ndikojë mbi të drejtat e punëtorëve emigrant apo anëtarëve të familjeve të tyre të fituara sipas ligjeve të këtij shteti, duke përfshirë këtu të drejtën për të tërhequr pagat apo përfitimet e tjera që i takojnë.

Neni 30

Çdo fëmijë i punëtorëve emigrant duhet të ketë të drejtën themelore për akses nëpër shkolla mbi bazën e trajtimit të barabartë me shtetasit e tjerë të shtetit në fjalë. Aksesit në institucionet arsimore para shkollave publike apo në shkolla nuk mund të refuzohet apo kufizohet me arsyetimin e situatës jo të ligjshme përse i takon qëndrimin apo punësimin të secilit prej prindërve, apo për shkak të parregullsive të fëmijës.

Sesioni 2: Emigracioni në vendet e Ballkanit Fletëpune 4



Skenarët e rasteve

Rasti 1: Ana, një grua 25 vjeçare, emigron nga vendi i saj për të kërkuar punë. Ajo nuk ka dokumente ligjore për të emigruar, por arrin ta kalojë kufirin. Ajo është e lumtur që arriti të gjente punë si rrobaqepëse në një fabrikë. Kushtet e punës janë të vështira dhe ndonjëherë pronari e mbyll nga jashtë derën e dhomës së qepjes ku punon Ana, kështu që ajo nuk mund të largohet. Një ditë, në bodrumin e ngushtë të fabrikës, ra një zjarr aksidental. Një nga vajzat u dëmtua rëndë pasi nuk kishte dalje emergjente. Pas aksidentit, ajo nuk mori asnjë asistencë nga pronari i fabrikës. Menjëherë pas këtij aksidenti, Ana i tha pronarit se kishte vendosur ta linte punën. Kur u kthye në shtëpi pas punës po atë natë ajo u sulmua nga një burrë, i cili e rrahu shumë keq. Ajo u zgjua në spital ku u desh të rrinte disa ditë para se të shkonte në polici për të bërë kallëzimin për sulmin. Policët refuzuan të kishin të bënin me çështjen e saj, pasi ajo ishte një emigrante e paligjshme.

Rasti 2: Një familje me kushte jetese shumë të varfëra dhe me probleme për gjetjen e punës pasi i përkiste një grupi minoritar emigroi në vendin fqinj në kërkim të një jete më të mirë. Ata nuk kishin kontakte në vendin ku shkuan, por gjetën një shtëpi të braktisur dhe u zhvendosën aty. Mamaja dhe babai arritën të gjenin punë sezonale në një fermë. Ata u përpoqën t'i fusnin fëmijët në një shkollë publike afër shtëpisë së tyre, por drejtori i shkollës refuzoi pasi familja nuk kishte dokumentacionin ligjor që të provonte se ata mund të qëndronin për një kohë të gjatë në këtë vend. Në vend që të shkonin në shkollë fëmijët filluan të lypnin nëpër rrugë. Pas njëfarë kohe, ata patën sasi të mjaftueshme të hollash sa për të blerë disa mobilje dhe një TV. Një mbasdite teksa u kthyen në shtëpi ata e gjetën atë të boshatisur dhe një oficer policie që po qëndronte jashtë u tha se ata duhet të largoheshin menjëherë nga shtëpia. Duke qenë se ishin emigrantë të paligjshëm, oficeri i policisë u tha se duhet të largoheshin menjëherë nga vendi dhe ata nuk arritën të merrnin sendet e tyre personale dhe mobiljet.

Rasti 3: Një grup i përbërë nga 20 meshkuj që i përkisnin të njëjtes shtetësi hynë ilegalisht në një shtet. Ata e kaluan natën në një hotel afër kufirit. Mëngjesin tjetër policia kufitare vajti në hotel dhe kërkoi të shihte dokumentacionin e tyre. Dy anëtarë të grupit treguan pasaportat e tyre, por ato nuk kishin vizë. Ata pretenduan se ishin emigrantë ekonomik (jo turistë, kërkues azili apo viktimë të ndonjë lloji), të cilët po emigronin për të punuar. Policia kufitare i grumbulloi të gjithë në një autobus dhe i drejtoi drejt kufirit – duke i rikthyer në vendin e origjinës. Burrat nuk arritën të kuptonin plotësisht ato çka po thoshte oficeri i policisë, por arritën të kuptonin se ata i kishin kthyer në shtëpi.



Duke Kërkuar një Jetë më të Mire: Historia e Jasminës⁴

Jasmina 15 vjeçare ishte vetëm 4 vjeç kur njerku i saj e shiti. E lindur në Shqipëri (vendi më i varfër në Europë) në një familje me 9 fëmijë, Jasmina kapi çmimin pre 25.000 Leke (rreth 190 \$). E thenë ndryshe, shitja e saj arriti ekuivalentin e 1/5 së të ardhurave mesatare vjetore. Në kontrast me Shqipërinë, fqinja e saj, Greqia, ka një ekonomi të fuqishme të mbështetur edhe nga turizmi në lulëzim. 1/5 e fuqisë punëtore në Shqipëri është pa punë dhe vitet e fundit kanë emigruar rreth 600.000 individë.

Blerësi ishte një burrë i quajtur Todi, një prej fqinjëve të familjes. “Ai i dha një shumë parash babait tim dhe ai më çoi atje – në Greqi,” thotë Jasmina. Si mijëra vajza dhe djem shqiptar, Jasmina përfundoi duke lypur në rrugët e Selanikut në Greqi, ku protektorët do ta gjenin pashmangshmërisht

Çdo vit, mijëra fëmijë shqiptar – shumica e tyre rom, kapërcejnë malet në kërkim të punës në Greqi, duke udhëtuar natën për të shmangur zbulimin. Rruga për në Selanik, qyteti i dytë për nga madhësia në Greqi, është rreth 100 milje nga kufiri. Zakonisht, fëmijët ecin gjatë gjithë rrugës. Shumë prej tyre bëjnë vizita të përsëritura. Jasmina e ka bërë rrugën Selanik – Shqipëri dhe anasjelltas me qindra here dhe ka kaluar shumë kohë prej jetës së saj nëpër rrugët e qytetit.

Jeta në rrugë është e vështirë, rebele dhe mizore. Djemtë dhe vajzat më të reja – si Jasmina kur mbërriti në fillim – shisinin lule dhe ornamente për turistët. Por, kur fëmijët arrinin moshën 12 ose 13 vjeçare, shumë prej tyre duhet t’i fitonin paratë nëpërmjet seksit. Një përqindje e lartë e vajzave detyroheshin të prostituonin dhe abuzoheshin nga protektorët dhe pronarët e shtëpive publike që i kontrollonin ato.

Vajzave nuk i’u thuhej vetëm se duhet të prostituonin, shpjegon Jasmina, por se ato duhet të fitonin një shumë të caktuar çdo natë. “Sot ti duhet të fitosh 5.000 lekë (më pak se 40\$),” thotë ajo. “Nuk e bën dot. Është natë dhe ti nuk e bën dot. Do të flesh në rrugë. Pastaj gjëja e keqe ndodh...”

Njerku i Jasminës, Agroni, i cili ka edhe 4 vajza të tjera që punojnë në Greqi dhe Itali, flet hapur për atë që ka bërë dhe për varfërinë që e ka shtyrë të veprojë në këtë mënyë. “Nëse do të kisha një punë të qëndrueshme, unë nuk do t’i dërgoja asgjëkundi fëmijët e mi,” thotë ai. Isha i detyruar t’i dërgoja pasi isha i varfër.” Agroni thotë se nuk ka patur një punë që prej 10 vjetësh.

“Aktualisht, prindërit i dërgojnë fëmijët e tyre në Greqi, sepse i shohin ata si një mundësi për të fituar të ardhura...,” thotë Namik Shehaj, Koordinator i Projektit me një organizatë të mbështetur nga UNICEF e quajtur NPF (“Ndihmoni Fëmijët”). “Arsyeja e vetme përse këta fëmijë trafikohen dhe shfrytëzohen është situata ekonomike shumë e varfër e familjes.

NPF punon kundër presionit shumë të madh ekonomik për t’i mbrojtur fëmijët nga shfrytëzimi. Duke vepruar në 4 qytete në Shqipëri, NPF identifikon fëmijët në rrezik trafikimi dhe ndihmon që ata të mund të shkojnë në shkollë. Gjithashtu, organizata i ndihmon familjet që të krijojnë një ambient kujdesues për fëmijët, që të marrin asistencë ekonomike dhe të gjejnë punë. Aktualisht, NPF po punon me rreth 600 fëmijë dhe familjet e tyre. Shumë prej fëmijëve me të cilët punon NPF e kanë lënë shkollën ose janë të rrezikuar që ta bëjnë këtë gje; organizata i ndihmon ata të gjejnë rrugët për të vazhduar shkollimin.

Gjatë verës, kur shkolla mbaron, shumë fëmijë largohen për në Greqi, kështu që NPF ka krijuar kampe verore për të krijuar idenë e komunitetit dhe si një alternative. Po ashtu, NPF garanton training profesional për më shumë se 200 fëmijë, duke përfshirë edhe Jasminën, e cila nuk po punon më nëpër rrugët e Selanikut.

“Më shiko pak,” thotë Jasmina, e cila ka studiuar për parukeri dhe rrobaqepësi. “Unë isha në Greqi. Tani jam këtu dhe po ndjek kurse...”

⁴ UNICEF Njesia e Trafikimit të Femijve, siç referohet në Mesime mbi Kundershtimin e Trafikimit të Femijes. Gjetet në <http://www.unicef.ca/education/childTrafficEn/Teaching2002.html>




Kartat e te Drejtave⁵ - Konventa e KB per te Drejtat e Femijeve

<p>Neni 6</p> <p>Çdo femije ka te drejte te qenesishme ndaj jetes</p>	<p>Neni 8</p> <p>Çdo femije ka te drejte te ruaj identitetin e tij/te saj, perfshire kombesine, emrin dhe marredheniet familjare siç parashikohen ne ligj, pa nderhyrje te pambeshtetura ne ligj.</p>
<p>Neni 11</p> <p>Shteti nuk ka asnje detyrim per parandalimin apo zgjidhjen e rasteve te rrembimit apo mbajtjes se femijeve ne shtete te tjera nga njeri prej prinderve apo personave te trete.</p>	<p>Neni 12</p> <p>Çdo femije qe eshte ne gjendje te krijoj mendimet e veta ka te drejten e shprehjes se lire te ketyre mendimeve ne te gjitha problemet qe ndikojne femijen, mendimet e femijes vleresohen bazuar ne moshen dhe pjekurine e femijes.</p>
<p>Neni 23</p> <p>Femijet e paafte menderisht ose fizikisht duhet te gezojne nje jete te plote dhe civile, ne kushte qe garantojne dinjitetin, promovojne pavaresine dhe lehtesojne pjesemarrjen aktive te femijes ne komunitet.</p>	<p>Neni 27</p> <p>Femijet kane te drejten te jetojne sipas nje standarti te pershtatshem per zhvillimin e tyre fizik, mendor, shpirtor, moral dhe social. Prinderit kane pergjegjesine kryesore te sigurojne e se femija i tyre gezon nje standart jetese te pershtatshem. Detyra e shtetit eshte te garantoje se kjo pergjegjesi permbushet.</p>
<p>Neni 28</p> <p>Femijet kane te drejten e shkollimit. Shkollimi fillestar duhet te jete falas dhe i detyrueshem. Shkollimi i nivelit vijues duhet te jete i aksesueshem nga çdo femije. Shkollimi i mesem duhet te jete i hapur per te gjithë mbi bazen e kapacitetit te gjithesecilit. Disiplina shkollore duhet te jete ne perputhje me te drejtat dhe dinjitetin e femijeve.</p>	<p>Neni 31</p> <p>Femijet kane te drejten te pushojne, zbavitene dhe te marrin pjese ne veprimtari artistike dhe kulturore.</p>
<p>Neni 32</p> <p>Femijet kane te drejten te jene te mbrojtur nga shfrytezimi ekonomik, nga detyrimi per te marre pjese ne pune qe jane te rrezikshme per shendetin, edukimin apo zhvillimin e tyre. Shteti duhet te percaktoje minimumin e moshes per punesim dhe duhet te rregulloje kushtet e punes. working conditions.</p>	<p>Neni 34</p> <p>Femijet duhet te jene te mbrojtur nga shfrytezimi dhe abuzimi seksual duke perfshire prostituimin dhe pornografine.</p>
<p>Neni 35</p> <p>Shteti duhet te marre gjithë masat e nevojshme per parandalimin e shitjes, trafikimit dhe rrembimit te femijeve.</p>	<p>Neni 39</p> <p>Femijet qe kane perjetuar konflikte te armatosura, torture, neglizhence apo shfrytezim duhet te marrin trajtimin e pershtatshem per reabilitimin dhe riintegrimin e tyre social.</p>

⁵ Adaptuar nga Njesia e Anti Trafikimit te UNICEF-it, siç referohet ne Mesimdhene ne Kundershtim te Trafikimit te Femijeve. Ndodhet ne <http://www.unicef.ca/education/childTrafficEn/Teaching2002.html>




Rrota e Kontrollit dhe e Pushtetit⁶



⁶ Burimi: Duluth, Minnesota Programi mbi Dhunen Gjinore. Marre nga Interneti me 19 gusht 2005, ne <http://www.letswrap.com/dvinfo/wheel.htm>



Rrota e Pushtetit dhe Kontrollit⁷



Frikësimi: ta bëjë të ndjehet e frikësuar nëpërmjet vështrimeve, veprimeve, gjesteve, shkatërrimit të gjërave, prishjes së pronës, abuzimit me kafshët shtëpiake, shfaqjes së armëve.

Abuzimi emocional: ta ulë, ta bëjë të ndjehet keq për veten e saj, ta thërrase në emër, ta bëjë që të mendojë se është e çmendur, lojërat e trurit, ta poshtërojë, ta bëjë që të ndjehet fajtorë.

Izolimi: ta kontrollojë se çfarë bën ajo, me kë takohet dhe më kë bisedon, çfarë lexon, ku shkon, të kufizojë daljet e saj duke përdorur xhelozinë për të justifikuar veprimet.

Minimizimi, mohimi dhe fajësimi: zhvlerësimi i abuzimit dhe mosmarrja seriozisht e shqetësimeve të saj lidhur me këtë abuzim, të thënit se abuzimi nuk ka ndodhur, heqja e përgjegjësisë për sjelljen abuzive duke thënë se ishte ajo që e shkaktoi.

Përdorimi i fëmijëve: fajësimi i saj për fëmijët, përdorimi i fëmijëve për të përcjellë mesazhe, bërja e kontrolleve për ta vënë në siklet, kërcënimet se do t'i marrë fëmijët.

Përdorimi i privilegjeve të burrave: trajtimi i saj si shërbëtoreshë, lënia e saj jashtë gjatë marrjes së gjithë vendimeve të rëndësishme, të vepruarit "si i zoti i kështjellës", të qenit ai që përcakton se cili është roli i grave dhe burrave.

Abuzimi ekonomik: ta ndalojë atë që të gjejë një punë apo të vazhdojë punën që ka, ta bëjë që ajo të lutet për të holla, t'i japë një sasi të vogël të hollash, të marrë paratë e saj, të mos e vërë në dijeni apo t'i ndalojë aksesin në të ardhurat e familjes.

Shtrëngimi apo kërcënimet: të bëjë dhe/apo të kryejë kërcënime për ta dëmtuar atë, ta kërcënojë se do ta lërë, se do të vrasë veten, ta bindë që ajo të tërheqë akuzat, ta detyrojë që ajo të bëjë gjëra të paligjshme.

⁷ Burimi: Duluth, Minnesota Program për Dhunen në Familje. Marrë nga Interneti më 19 gusht 2005 në adresën <http://www.letswrap.com/dvinfo/wheel.htm>



VESHTRIM I PERGJITHSHEM MBI DHUNEN NE FAMILJE

Dhuna në familje përfshin dhunën e ushtruar nga partnerët intim dhe anëtarët e tjerë të familjes dhe të manifestuar nëpërmjet: ⁸	
Abuzimit fizik	Goditja, rrahja, përdredhja e krahut, sulmi me thikë, mbytja, djegia, prerja, goditja me shkelma, kërcënimi me një objekt apo armë dhe vrasja. Ajo përfshin edhe praktikatat tradicionale të dëmshme për gratë si prishja e funksioneve të organeve gjentile femërore dhe trashëgimia e gruas (praktika e kalimit të një vejushe dhe i pronës së saj te vëllai i burrit të vdekur).
Abuzimit seksual	Seksi i detyruar nëpërmjet kërcënimeve, frikësimit apo forcës fizike, kryerja e akteve seksuale të padëshiruara nëpërmjet forcës apo detyrimi për të kryer akte seksuale me persona të tjerë.
Abuzimit psikologjik	Sjellje që ka për qëllim ta frikësojë dhe persekutojë, e cila merr formën e kërcënimeve për abandonim apo abuzim, mbylljes në shtëpi, survejimit, kërcënimeve se do të marrë kujdestarinë e fëmijëve, shkatërrimit të objekteve, izolimit, agresionit me fjalë dhe poshtërimin të vazhdueshëm.
Abuzimit ekonomik	Mohimi i të ardhurave, refuzimi për të kontribuar financiarisht, mohimi i ushqimit dhe nevojave kryesore dhe kontrolli i aksesit për kujdes shëndetësor, punësim etj.
Aktet e lënies pas dore	Kontrolli apo kufizimi i aksesit për ushqim, shkollim, dhe kujdes shëndetësor

⁸ Innocenti Digest (Nr. 6 qershor 2000, fq.2). *Dhuna në familje kundër grave dhe vajzave. UNICEF*. E marrë nga Interneti më 18 gusht 2005 nga faqja <http://www.unicef-icdc.org/publications/pdf/digest6e.pdf>



1. Burrë – Grua; I dashur – E dashur

2. Prindër – Fëmijë

Si burrat dhe grate kryejnë akte dhune kundër fëmijëve.

3. Fëmijë madhor – Prindër

Ndonjëherë ata që janë abuzuar nga prindërit e tyre në fëmijëri e kthejnë këtë dhunë ndaj prindërve të tyre kurr rriten.

4. Fëmijë më të rritur – Fëmijë më të vegjël

5. Një anëtar i familjes – Një anëtar tjetër i familjes

Kjo dhunë është një akti i kryer nga një anëtar i familjes ndaj një anëtari tjetër të famijes. Ushtruesit e dhunës mund të jenë vjehërra, kunata, kunati, gjyshja, gjyshi, fëmijët, xhaxhai apo daja etj. Në këtë rast anëtarët më të fortë të familjes abuzojnë me anëtarët më të dobët (të moshuarit, fëmijët, njerëzit me paaftësi mendore apo fizike, personat dipendent etj.).

Shembuj të dhunës kundër grave përgjatë gjithë ciklit jetësor¹⁰

<i>Faza</i>	<i>Lloji i dhunës së ushtruar</i>
Paralindja	Abortimi sipas seksit, efektet në lindje të rrahjeve gjatë shtatzënisë.
Fëmijëria	Vrasja e foshnjeve femra; abuzimi seksual, fizik dhe psikologjik
Vajzëria	Martesa që fëmijë; prishja e funksioneve gjenitale femërore, abuzimi seksual, fizik dhe psikologjik, incesti, prostituimi i fëmijëve dhe pornografia.
Adoleshenca dhe Pjekuria	Dhuna gjatë takimeve dhe vardisjeve (p.sh. hedhja e acidit dhe përdhunimi në takim); seks ekonomikisht i detyruar (p.sh. vajzat e shkollave që kryejnë seks me burra të rritur për të garantuar tarifat e shkollës); incesti; abuzimi seksual në vendin e punës; përdhunimi; ngacmimi seksual; prostituimi dhe pronografia e detyruar; trafikimi i grave; dhuna e partnerit; përdhunimi martesor; abuzimi me pajën/prikën dhe vrasja; vrasja e partnerit; abuzimi psikologjik; abuzimi me grate që kanë paaftësi; shtatzënia e detyruar.
Mosha e madhe	“Vetëvrasja” e detyruar apo vrasja e vejushave për arsye ekonomike; abuzimi seksual, fizik dhe psikologjik.

⁹ Pjesë nga: Winrock International (2001). *Parandalimi i Dhunës në Familje dhe Trafikimit të Qenieve Njerëzore: Manual Trainues, Winrock international, Kiev, Ukraine*

¹⁰ “Dhuna kundër grave”, WHO., FRH/WHO/97.8, sikurse është referuar te Innocenti Digest (Nr. 6 qershor 2000, fq.3). *Dhuna në familje kundër grave dhe vajzave. UNICEF. E marrë nga Interneti më 18 gusht 2005 nga faqja <http://www.unicef-icdc.org/publications/pdf/digest6e.pdf>*



Dhuna Dhuna në familje kundër grave¹¹ – Shpërndarja nëpër botë

Vendet e industrializuara
Kanada: 29% e grave (një grup përfaqësues në shkallë kombëtare i përbërë nga 12,300 gra) raportuan se ishin goditur fizikisht nga një partner aktual apo një ish partner që prej moshës 16 vjeçare.
Japoni: 59% e 796 grave të anketuara në vitin 1993 raportuan se ishin abuzuar fizikisht nga partneret e tyre
Zealanda e Re: 20% e 314 grave të anketuara raportuan se ishin goditur apo abuzuar fizikisht nga një partner mashkull.
Zvicër: sipas një ankete të vitit 1997, 20% e 1,500 grave raportuan se ishin goditur fizikisht
Mbretëri e Bashkuar: 25% e grave (një grup i rastësishëm i grave të një distrikti) kanë raportuar se gjatë jetës së tyre janë rrahur apo goditur nga partneri apo një ish partner.
Shtete e Bashkuara: 28% e grave (një grup përfaqësues në shkallë kombëtare) raportuan se kishin patur të paktën një episod të dhunës fizike nga partneri i tyre.
Azia dhe Pacifiku
Kambozhia: 16% e grave (një grup përfaqësues në shkallë kombëtare) raportuan se kishin qenë të abuzuara fizikisht nga bashkëshortët; 8% raportuan se ishin dëmtuar.
India: Sipas një anketimi të vitit 1996 të 6, 902 burrave në shtetin e Uttar Pradesh, deri në 45% e burrave të martuar pranuan se abuzonin fizikisht me gratë e tyre.
Korea: Sipas anketimit të një grupi të rastësishëm të grave të martuara, 38% e tyre raportuan se ishin abuzuar fizikisht nga bashkëshortët e tyre.
Tailand: 20% e burrave të martuar (një grup përfaqësues i përbërë nga 619 burra) pranuan se kishin abuzuar fizikisht me grate e tyre të paktën një herë gjatë martesës.
Lindja e Mesme
Egjypt: 35% e grave të martuara (një grup përfaqësues në shkallë kombëtare) raportuan se ishin rrahur nga burrat e tyre në një periudhë të caktuar të martesës.
Izrael: Sipas një anketimi të vitit 1997 të 1, 826 grave arabe, 32% e tyre raportuan se kishin patur të paktën një episod të abuzimit fizik nga partneri i tyre dhe 30% raportuan se gjatë viti të kaluar kishin kryer seks të detyruar nga bashkëshortët e tyre.
Afrika
Kenia: 42% e 612 grave të anketuara në një distrikt raportuan se ishin rrahur nga një partner; nga këto, 58% raportuan se ishin rrahur shpesh ose disa herë.
Uganda: 41% e grave raportuan se ishin rrahur apo dëmtuar fizikisht nga një partner; 41% e burrave raportuan se e kishin rrahur partneren e tyre (një grup përfaqësues i grave dhe partnerëve të tyre në dy distrikte).
Zimbabve: Sipas një anketimit të vitit 1996, 32% e 966 grave në një provincë raportuan se kishin patur abuzim fizik nga një anëtar apo pjesëtar i familjes që prej moshës 16 vjeçare.
Amerika Latine dhe Karaibet
Kili: 26% e grave (një grup përfaqësues i grave nga Santiago) raportuan të paktën një episod të dhunës nga një partner, 11% raportuan të paktën një episod të dhunës së ashpër dhe 15% e grave raportuan të paktën një episod të një dhune më pak të ashpër.
Kolumbi: 19% e 6,097 grave të anketuara raportuan se gjatë jetës së tyre ishin dhunuar fizikisht nga partnerët e tyre.
Meksike: Sipas një raporti të vitit 1997, 30% e 650 grave të anketuara në Guadalajara raportuan të paktën një episod të dhunës fizike nga një partner; 13% raportuan dhunë fizike gjatë vitit të kaluar.
Nikaragua: Sipas një raporti të vitit 1996, 52% e grave (një grup përfaqësues i grave në Leon) raportuan se ishin abuzuar fizikisht nga partneri të paktën një herë; 27% raportuan se ishin abuzuar fizikisht gjatë vitit të kaluar.
Europa Qëndrore dhe Lindore/Konfederata e Shteteve të Pavarura/Shtetet e Balltikut
Estoni: Sipas një anketimi të vitit 1994 të 2,315 grave doli se 29% e grave të moshës 18-24 vuanin nga dhuna në familje dhe përqindja rritet me kalimin e moshës, duke prekur 52% të grave nga 65 vjeç e sipër.
Poloni: 60% e grave të divorcuara të anketuara në vitin 1993 nga Qendra për Ekzaminimin e Opinimit Publik raportuan se ishin goditur të paktën një herë nga ish burrat e tyre; një 25% raportoi dhunë të përsëritur.
Rusi (St. Petersburg): 25% e vajzave (dhe 11% e djemve) raportuan marrëdhënie seksuale të padëshiruara, sipas një anketimi të 174 djemve dhe 172 vajzave në klasën e 10 (të moshës 14-17 vjeçare).
Taxhikistan: Sipas një anketimi, 23% e 550 grave të moshës 18-40 vjeç raportuan abuzim fizik.

¹¹ E përshtatur nga "Dhuna kundër Grave," WHO, FRH/WHO/97.8, "Gratë në Tranzicion," Raport Monitorues Rajonal, UNICEF 1999, dhe një studim nga Qendra Kërkimore për Dhunën në Familje, Japoni, sikurse referohet të Innocenti Digest (Nr. 6 qershor 2000, fq.7). Dhuna në familje kundër grave dhe vajzave. UNICEF. Marrë në datën 18 -08-05 nga faqja e Internetit <http://www.unicef-icdc.org/publications/pdf/digest6e.pdf>



Faktorët që ‘mbajnë gjallë’ dhunën në familje¹²

Kulturor

- Socializimi specific sipas gjinisë
- Përkufizimet kulturore të roleve të duhura të seksit
- Pritshmëria e roleve brenda marrëdhënieve
- Besimi në superioritetin e lindur të meshkujve
- Vlerat që i japin meshkujve të drejta pronësie mbi grate dhe vajzat
- Nocioni i familjes si një sferë private dhe nën kontrollin e meshkujve
- Zakonet e martesës (çmimi i nuses/paja, prika)
- Pranimi i përdorimit të dhunës si një mjet për zgjidhjen e konflikteve

Ekonomik

- Varësia ekonomike e grave ndaj burrave
- Akses i kufizuar në të holla dhe kredite
- Ligjet diskriminuese përsa i përket trashëgimisë, të drejtave të pronës, përdorimit të tokave shtetëror, mbështetjes pas divorcit apo mbetjes vejtshë.
- Akses i kufizuar për punësimin në sektorët formal dhe informal
- Akses i kufizuar për shkollimin dhe trainimin e grave

Ligjor

- Status më i ulët ligjor i grave nga ligji i shkruar dhe/ose praktika
- Ligjet për divorcin, kujdestarinë e fëmijëve, mbështetjen dhe trashëgiminë
- Përkufizimet ligjore mbi përdhunimin dhe abuzimin në familje
- Nivele të ulëta të njohurive të grave për literaturën ligjore
- Trajtimi i ashpër i grave dhe vajzave nga policia dhe gjyqësori

Politik

- Shkalla e ulët e përfaqësimit të grave në pushtet, politik, media, në profesionet ligjore dhe mjekësore
- Mosmarrja shumë seriozisht e dhunës në familje
- Nocionet se familja është diçka private dhe jashtë kontrollit të shtetit
- Rreziku i kundërshtimit të ligjeve status quo/fetare
- Organizatat e kufizuara të grave si force politike
- Pjesëmarrja e kufizuar e grave në sistemin politik të organizuar

¹² Heise. 1994 sikurse referohet në Innocenti Digest (No. 6 Qershor 2000, fq.7). *Dhuna në familje kundër grave dhe vajzave*. UNICEF. E marrë nga Interneti më 18 gusht 2005 nga faqja <http://www.unicef-icdc.org/publications/pdf/digest6e.pdf>



Legjendat dhe Realitetet për Dhunën në Familje¹³

Pohimi: Dhuna në familje vjen për shkak të vërfërisë apo mungesës së shkollimit.

Përgjigja: False. Dhuna në familje është e zakonshme në të gjitha nivelet e shoqërisë, qofshin të pasura apo të varfra. Shpesh është më e thjeshtë ta fshehësh dhunën kur një individ ka para dhe miq të rëndësishëm, por gjithësesi ajo ndodh. Nuk ka të dhëna për të mbështetur idenë se njëriçit e varfër apo të pashkolluar janë më të predispozuar që të abuzojnë me gratë apo partneret e tyre sesa individët më të shkolluar apo më të pasur.

Pohimi: Përdorimi i alkoolit dhe drogës është një shkak kryesor që shkakton dhunën në familje.

Përgjigja: False. Megjithëse alkooli dhe droga janë shpesh të lidhura me dhunën në familje, nuk janë ata shkaktarë të dhunës. Shumë burra që i rrahin gratë e tyre nuk konsumojnë alkool. Burrat që pijnë dhe rrahin gratë e tyre zakonisht nuk rrahin njerëz të rastësishëm në rrugë, prindërit apo shefat e tyre. Burrat që i qëllonë gratë e tyre shpesh vazhdojnë ta bëjnë këtë gjë edhe pasi nuk pijnë më. Një abuzues mund të përdorë alkoolin si një justifikim për dhunën, apo alkooli mund ta pengojë që të kuptojë nivelin e forcës që përdor, por alkooli nuk është shkak. Dhuna në familje dhe abuzimi me substancat mund të shihen dhe trajtohen si probleme të veçanta.

Pohimi: Një grua që qëllohet ka shumë shkaqe të justifikueshme që të qëndrojë në një marrëdhënie të dhunshme.

Përgjigja: E vërtetë. Ka shumë arsye kulturore dhe ekonomike për të cilat një grua vendos të qëndrojë në një marrëdhënie abuzive. Këto arsye janë racionale. Shpesh, ajo nuk një vend ku të shkojë. Ajo mund të mos ketë një mënyrë për të mbajtur veten apo fëmijët e saj nëse largohet, ndjehet e turpëruar apo e poshtëruar për shkak të abuzimit, apo frikësohet se miqtë, familja apo komuniteti do të fajësojnë atë për abuzimin. Ajo mund të hezitohet të largohet për arsye emocionale apo fetare. Përveç këtyre, vetë largimi mbart disa rreziqe. Ajo mund të frikësohet pasi ushtruesi i dhunës mund ta kërcënojë se do të dëmtojë atë, fëmijët, miqtë apo familjen e saj. Gratë që qëllohen janë në një rrezik shumë të madh nëse duan të largohen pasi mund të përfundojnë të dëmtuara rëndë apo edhe të vdekura. Për këtë arsye, ato janë të vetmet që mund të gjykojnë se kur është momenti më i sigurt për tu larguar.

Pohimi: Një grua që abuzohet e lë shumë herë burrin e saj.

Përgjigja: E vërtetë. Në kundërshtim me teoritë e dhunës në familje që i portretizojnë gratë që abuzohen si të pafuqishme, shumica e grave që i mbijetojnë marrëdhënieve abuzive largohen shpesh herë dhe zakonisht veprojnë në mënyra të vetëdijshme duke u përpjekur të minimizojnë abuzimin që ushtrohet ndaj tyre dhe të mbrojnë fëmijët.

Pohimi: Burrat janë viktimat të dhunës në familje po aq sa edhe gratë.

Përgjigja: False. Studimet tregojnë se në 95% të rasteve të dhunës në familje viktimat janë gra. Sa i takon dhunës së përdorur nga gratë, ajo zakonisht bëhet për vetëmbrojtje. Raportet e dhunës kundër burrave shpesh janë të ekzagjeruara, pasi abuzuesit i akuzojnë partnerët e tyre për përdorim të dhunës si një mënyrë për të evituar apo minimizuar përgjegjësitë e tyre. Po ashtu, burrat që kanë patur përvoja të dhunës në familje kanë më shumë akses sesa gratë për të përdorur mjete dhe mënyra për tu larguar nga situatat e dhunës.

Pohimi: Kushdo e njih një viktimitë të dhunës në familje.

Përgjigja: E vërtetë. Ne të gjithë i njohim viktimat. Kudo nëpër botë, ¼ - ½ e gjithë grave përjetojnë situata dhune në një marrëdhënie intime. Viktimat e dhunës në familje mund të mos e tregojnë abuzimin që ushtrohet ndaj tyre për shkak të turpërimit apo poshtërimit, frikës se do të jenë ato që do të fajësohen për abuzimin dhe rrezikut të hakmarrjes nga personi abuzues.

Pohimi: Burrat që abuzojnë janë të dhunshëm sepse ata nuk arrijnë të kontrollojnë zemërimin dhe inatin.

Përgjigja: False. Dhuna në familje është një sjellje e qëllimshme dhe dhunuesit nuk e kanë veten jashtë kontrollit. Dhuna e tyre drejtohet me kujdes në njerëz të caktuar, në kohë dhe vende të caktuara. Zakonisht, ato nuk sulmojnë shefat apo njerëz të rastësishëm në rrugë, sado të inatosur që të jenë. Gjithashtu, abuzuesit ndjekin rregullat e tyre të brendshme për sjelljet abuzive. Shpesh ata zgjedhin të abuzojnë me prindërit e tyre vetëm privatisht, apo marrin masa që të mos lënë prova të dukshme të abuzimit. Po ashtu, ushtruesit e dhunës i zgjedhin me kujdes taktikat e tyre – disa shkatërrojnë pronën, disa përdorin kërcënimet për abuzim, dhe disa kërcënojnë fëmijët. Studimet tregojnë se në fakt, disa dhunues bëhen më të kontrolluar dhe të qetë ndërsa agresiviteti i tyre rritet.

Pohimi: Dhuna në familje është një problem, por vetëm në zonat e largëta rurale.

Përgjigja: False. Dhuna në familje është dokumentuar si në zonat rurale ashtu edhe në ato urbane. Dhuna në familje është kudo një problem.

¹³ Minnesota, Mbrojtësit e të drejtave të njeriut (2003) marrë nga Interneti më 19 gusht 2005 në faqen <http://www.stopvaw.org>.



**PERSE GRATE E KANE TE VESHTIRE TE LARGOHEN NGA NJE SITUATE APO
MARREDHENIE E DHUNSHME?¹⁴**

1. Varësia financiare nga burri.
2. Frika se partneri mund ta rrahë apo vrasë.
3. Dashuria për partnerin. Dëshira për të qenë bashkë.
4. Frika se mos humbet fëmijën.
5. Shpresa se gjërat do të përmirësohen me kalimin e kohës dhe se ajo do të jetë në gjendje ta kontrollojë situatën.
6. Frika se divorci mund të shkaktojë traumë psikologjike të fëmijët.
7. Frika se mund të trajtohet si dështake nga familja, miqtë dhe shoqëria.
8. Bindjet fetare.
9. Ndjenjat e dëshpërimit dhe të qënies së paspresë (“Asgjë nuk do të ndihmojë”).
10. Reagimi jo favorizues i shoqërisë ndaj këtij problemi në përgjithësi (ekzistenca e stereotipeve).
11. Qëndrimi i papërshtatshëm i personelit të institucioneve përkatëse shtetërore që merren me këtë problem (policia, gjykatat, agjensitë e shërbimeve sociale):
 1. si rregull, personeli i policisë e konsideron dhunën në familje si një çështje private të familjes;
 2. gjyqtarët ndonjëherë mendojnë se janë vetë gratë provokatore të situatës abuzive;
 3. punonjësitë social nuk mendojnë se kanë kohë të mjaftueshme që të merren me këtë problem, pasi kanë shumë punë të tjera.
12. Vetëfajësimi për dhunën e ushtruar kundër saj (“Unë e kërkova ... Unë duhet të fajësohem”).
13. Frika se partneri mund ta dëmtojë atë, gjë që do të dëmtonte imazhin e saj social apo profesional, miqtë e ngushtë apo të afërmit.
14. Duhet mjaft kohë për të planifikuar dhe përgatitur largimin.
15. Bindja e gruas se ajo nuk mund të jetojë e pavarur se është shumë budallaqe, shumë e shëndoshë apo e dobët, invalide, për të ardhur keq apo diçka tjetër.
16. Frika dhe pasiguria për të ardhmen.
17. Frika e humbjes së shtëpisë apo pronës (mungesa e një strehe alternative).
18. Frika se mund të përfundojë pa një partner dhe vuajtja nga vetmia.
19. Dëshira për ta mbajtur të fshehtë nga të tjerët dhunën që ushtrohet kundër saj.
20. Stres psikologjik kronik, i cili shkakton lodhje (“Jam shumë e lodhur për të bërë përpjekje që të ndryshojë ndonjë gjë”).
21. Frika për të ardhmen e fëmijëve.
22. Pranimit kulturor i konceptit se një grua është përgjegjëse për klimën që krijohet në familje (dhe, në mënyrë indirekte, për çdo gjë që mund të ndodhë).
23. Presioni nga të afërmit (këshillat e tyre të formës “Ai është burri yt, babai i fëmijëve të tu”).
24. Dëshira për ta mbajtur familjen të bashkuar.
25. Nuk ka se ku të shkojë, nuk ka para për të siguruar qëndrimin diku me qera.
26. Mungesë totale e mbështetjes sociale apo ligjore.
27. Aftësi fizike të kufizuara, të cilat sjellin varësinë e saj nga një person tjetër.
28. _____
29. _____

¹⁴ Pjesë nga: Winrock International (2001). *Parandalimi i Dhunës në Familje dhe Trafikimit të Qenieve Njerëzore: Manual Trainues, Winrock international, Kiev, Ukraine*



STUDIMET E RASTEVE - SHFRYTËZIMI SEKSUAL DHE DHUNA PËR SHKAK TË GJINISË

Rasti 1: Tamara ka qenë e martuar me Michael për 2 vjet. Në fillim të marrëdhënies, Michael donte ta kalonte gjithë kohën me Tamarën dhe ishte shumë i vëmendshëm ndaj saj. Ai e mbulonte me komplimenta dhe ajo nuk i rezistoi dot më. Pak kohë pasi ishin martuar ajo mbeti shtatzënë me djalin e tyre. Michael filloi ta trajtonte në mënyrë të çuditshme. Në fillim u duk sikur nuk kishte besim te ajo dhe vinte në shtëpi papritur në mes të ditës dhe dukej i habitur që e gjente atë në shtëpi vetëm me fëmijën. Ai e pyeste nëse ajo ishte veshur këndshëm dhe nëse i kishte thonjtë e rregulluar. Kur fëmija ishte 1 vjeç, Michael filloi ta godiste Tamarën. Pasi ndodhte kjo gjë atij i vinte shumë keq dhe i lutej që ajo ta falte. Në fillim ajo e fali. Ajo u shokua nga sjellja e tij, por mendoi se ajo mund të ishte shkaktuar nga stresi i madh që kishte në punë. Shumë shpejt, kjo sjellje u përsërit dhe ai e goditi përsëri. Më pas kjo gjë u bë gjithmone dhe me e shpeshtë. Së fundi, Tamara mori fëmijën dhe u largua. Ajo u kthye në shtëpinë e nënës së saj, por e ëma ishte pensioniste dhe të tre e patën të vështirë të mbijetonin. Michael refuzoi të jepte ndihmë për Tamarën dhe djalin e tyre për aq kohë sa ata nuk do të jetonin së bashku. Një fqinjë i tha Tamarës se një burrë po kërkonte për gra që të punonin si punëtore shtëpish në Itali. Pagesa ishte shumë e mirë dhe ai do të bënte të gjitha rregullimet e nevojshme për udhëtimin dhe dokumentet e punës. Tamara e rrëmbeu shansin që të fitonte para për të ndihmuar nënën dhe djalin e saj.

1. Cilët janë elementet evident të dhunës për shkak të gjinisë në këtë histori?
2. Si ndikoi dhuna mbi vendimin që mori Tamara?
3. Cilat janë pasojat e mundshme negative dhe pozitive të vendimit të Tamarës për të emigruar?



Rasti 2: Për Alenën po bëhej gjithmonë e më e vështirë shkëputja nga krevati dhe përballja me çdo ditë të re. I shoqi i saj kishte pak kohë që kishte vdekur në një aksident rrugor të tmerrshëm. Ata kishin dy fëmijë të vegjël dhe Alena kishte qëndruar në shtëpi duke u marrë me rritjen e fëmijëve. Burri i saj kishte patur një punë të paguar mirë, por ajo nuk ishte shoqëruar me përfitime dhe kur ai vdiq të ardhurat u ndërpre në menjëherë. Duke qene se ishte jetime ajo nuk kishte një familje ku mund të kthehej. Në fillim, vëllezërit e të shoqit u përpoqën ta ndihmonin – ata i sillnin ushqime dhe kujdeseshin për mbajtjen e shtëpisë, por ata kishin familjet e tyre dhe pak kursime për te shpenzuar. Alena kishte një shkollim të ulët dhe nuk kishte punuar kurrë. Ajo shkoi në çdo dyqan të qytetit për të kërkuar punë. Ajo shkoi në zyrën e punësimit. Askush nuk i ofroi asgjë. Ajo u detyrua t’i lutej pronarit të dyqanit të ushqimeve që të blinte ushqime me kredi (me listë). Ai pranoi, por ajo shqetësohej se si do t’ia shlyente borxhin. Ai i tha të mos shqetësohej. Por një mbrëmje, ai i shkoi në shtëpi dhe i kërkoi shlyerjen e detyrimit. Ajo i tha se nuk i kishte akoma paratë, por do të përpiqej që t’i gjente. Ai i tha se kishte një mënyrë tjetër dhe i ofroi t’i jepte të gjitha ushqimet që i duheshin nëse ajo do të flinte me të. Ajo refuzoi. Ai i tha se në dyqanin e tij nuk do të kishte më kredite. Alena e dinte se pa kredite fëmijët e saj do të vdisnin nga uria. Ajo kuptoi se nuk kishte zgjidhje tjetër veçse të pranonte. Disa javë më vonë djali i saj u sëmur rëndë, por ajo nuk kishte para që të merrte doktorin. Ajo foli me pronarin e dyqanit të ushqimeve, por ai i tha se nuk mund ta ndihmonte dot më shumë. Ai po bënte gjithçka mundej për të. Shumë shpejt në derën e saj erdhi një burrë tjetër, të cilin e kishte dërguar pronari i ushqimores. Ai i ofroi para për të bërë seks. Ajo mendoi për të birin dhe kuptoi se nuk mund të refuzonte.

1. Në ç’ mënyrë bëhen evidente rolet tradicionale të gjinive në këtë histori?
2. Cili është ndikimi i roleve të gjinisë mbi jetën e Alenes pas vdekjes së të shoqit?
3. A është Alena një prostitutë? Diskutoni përgjigjet.
4. A është Alena viktimë e trafikimit? Diskutoni përgjigjet.
5. Cili është roli i pronarit të ushqimores në histori? A mund të konsiderohen veprimet e tij si një dhunim për shkak të gjinisë? Pse po dhe pse jo?
6. Cili është roli i shoqërisë si një e tërë në këtë histori? Kush do të përgjigjet për Alenën dhe fëmijët e saj?



Rasti 3: Jeta familjare e Marisë është shumë stresante. Babai i saj ka një temperament të tmerrshëm. Me kalimin e viteve, Maria dhe motrat e saj i kanë studiuar me kujdes gjendjet e tij dhe përpiqen të shmangen kur ai është i inatosur për të mos provokuar zemërimin e tij kundër tyre. Kohët e fundit situata u përkeqësua pasi babai i tyre humbi punën. Paratë ishin të pakta – vetëm të ardhurat që nxirrte e ëma – dhe babai po pinte shumë duke qenë se rrinte pasiv gjatë gjithë ditës. Por jo shumë kohë më parë, Maria takoi një djalë. Një burrë të ri – ai ishte vetëm pak më i madh se ajo. Ai ishte shumë i sjellshëm me Marinë. Ai u inatos kur ajo i tregoi për të atin dhe i tha se ajo meritonte një jetë më të mirë. Dhe mbi të gjitha, ai kishte vendosur që t'i ofronte asaj një jetë më të mirë. Sapo ajo të mbushte 18 vjeç ata do të martoheshin dhe do të shkonin në Angli, ku një i afërm i kishte premtuar atij një punë të mirë në ndërtim.

Prindërit e saj më në fund ranë dakord dhe ajo së bashku me Aleksandrin u martuan pak pasi ajo mbushi 18 vjeç. Ata vajtën në Angli dhe qëndruan me kushëririn e Aleksandrit sipas planit që kishin bërë. Por, puna që premtoi kushëririn nuk u materializua kurrë. Aleksandri i shpjegoi se ata duhet të prisnin derisa të rregulloheshin dokumentet. Në të njëjtën kohë, Xhaxhai i Aleksandrit – babai i kushëririn – u sëmur dhe ai së bashku me kushëririn po përpiqeshin të mblidhnin lekë për operacionin. Një natë, në shtëpi erdhi një burrë i çuditshëm. Ai i kushtoi shumë vëmendje Marisë aq sa ajo u vu shumë në siklet dhe u detyrua të largohej nga dhoma. Aleksandri shkoi te ajo dhe i tha se kishte vetëm një mënyrë për t'i nxjerrë paratë në kohën e duhur për opeacionin – ky burrë e pëlqente së tepërmi Marinë dhe ishte i gatshëm të paguante shumë para nëse ajo do të bënte seks me të. Maria u përpoq të kundërshtonte, por Aleksandri ishte këmbëngulës dhe i'u lut ta bënte vetëm një herë këtë gjë për të shpëtuar jetën e Xhaxhait. Më së fundi ajo pranoi, por ky ishte një vendim fatal. Shumë shpejt burri filloi të vinte rregulisht në shtëpi. Në fillim Aleksandri harxhonte kohë duke u përpjekur ta bindte se kjo do të ishte hera e fundit, por nuk kishte më nevojë për justifikime, kjo do të ishte jeta e re e Marisë

1. Në ç'mënyrë bëhen evidente rolet tradicionale të gjinisë në këtë histori?
2. Cilat janë elementet evidente të dhunës për shkak të gjinisë në këtë histori?
3. Cili është ndikimi i roleve të gjinisë dhe dhunës për shkak të gjinisë në vendimin që mori Maria?
4. A është Maria një prostitutë? Diskutoni përgjigjet.
5. A është Maria viktimë e trafikimit? Diskutoni përgjigjet.
6. Pse nuk largohet Maria nga burri i saj?

Sesioni 5: Roli i Shkollës në Parandalimin e Trafikimit Fletëpunë 1



Roli i Mësueve në Klasë¹⁵

Nr	Roli i mësuesit	Sjellja e tij	Ndikimi mbi grupin
1	Demonstrues	<ul style="list-style-type: none"> • Prezantimi i çështjeve specifike • Flet vetëm ai 	<ul style="list-style-type: none"> • E vë auditorin në punë për të realizuar detyrat që i janë ngarkuar • E bën auditorin të ndjehet i përfshirë/pjesëmarrës • E bën auditorin të ketë më shumë vetëbesim
2	Mbrojtës	<ul style="list-style-type: none"> • Përdor fjalë qëi bindin të tjerët për ato që thotë • E ruan dhe e mbron pozitën e tij • E vë në dukje se është i fortë 	<ul style="list-style-type: none"> • E vë grupin në punë për të analizuar aktivitetin e kryer apo produktin që ka dalë • E vë grupin në punë për të vënë në provë punën e bërë apo produktin që ka dalë.
3	Ekspert	<ul style="list-style-type: none"> • Jep informacion • Faktin • Përdor shpesh referimet • Përdor zë autoritar • Nuk është ekuivok, nuk përdor fjalë të tilla si “ndoshta”, por përdor fjalën “gjithmonë” 	<ul style="list-style-type: none"> • Hapësira të vogla për diskutime • I bën disa grupe më pak të interesuar • I bën disa grupe të ndjehen mirë; auditorit i pëlqen të dëgjojë se sa shumë ju duan ata juve
4	Autoritar	<ul style="list-style-type: none"> • Ai është i veçantë • Udhëheqës i grupit • “Kështu qoftë” 	<ul style="list-style-type: none"> • Ai mund t’i frikësojë pjesëmarrësit në trainim • Ndoshta disa të tjerë do ti “kursejë”
5	Këshillues	<ul style="list-style-type: none"> • Ai dëgjon • Ai sugjeron • Ai sqaron çdo gjë para se të përgjigjet • Ai përgjigjet çdo nevojë 	<ul style="list-style-type: none"> • Jep mundësi për mbylljen e diskutimeve në grup • Garanton përfshirjen sa më të plotë të grupit • Zhvillon ndjenjat e mira
6	Instruktor	<ul style="list-style-type: none"> • Ai shpërndan informacion • Ai është elastik • Ai është vëzhgues • Ai bën vlerësime • Ai është udhëheqës 	<ul style="list-style-type: none"> • Ai krijon marrëdhënie të mira me grupin • Ai e bën grupin të ndjeje se ka mësuar diçka
7	Manipulator	<ul style="list-style-type: none"> • I bën të ndjehen të vlerësuar edhe të pakualifikuarit • I kthen pjesëmarrësit në kavië 	<ul style="list-style-type: none"> • Grupi ndjehet se “ai po përdoret si objekt”
8	Konfrontues	<ul style="list-style-type: none"> • Ai përpiket të qëndrojë më gjatë me dikë që e ka keqkuptuar çështjen. • Ai shprehet për çështjen/problemin 	<ul style="list-style-type: none"> • Nuk di më shumë • Mund ta zgjidhë çështjen
9	Moderator	<ul style="list-style-type: none"> • I kërkon pjesëmarrësve të prezantojnë çështjen apo konceptet • Bën urën lidhëse midis prezantimeve të ndryshme (i lidh së bashku) 	<ul style="list-style-type: none"> • E lejon grupin të marrë informacion në drejtime të ndryshme • Grupi kupton logjikën e prezantimeve dhe lidhjet midis tyre
10	Ndihmës	<ul style="list-style-type: none"> • Nxiti pjesëmarrjen aktive të auditorit • Ai tërheq idetë e grupit • Nxiti shqyrtimin dhe zbulimin e pavaruar 	<ul style="list-style-type: none"> • Auditori do të jetë “zotëruesi” i procesit të të mësuarit • Ai punon në bashkëpunim me grupin • Auditori përfshihet në nivele të ndryshme të diskutimit • Auditori e di vlerën reale të njohurive (më përpara)

¹⁵ *Burimi*: “Mendimi kritik nëpërmjet të shkruarit dhe lexuarit”. Projekt, i mbështetur nga Fondacioni “Soros” gjatë viteve 1998-2001 dhe i zbatuar në Shqipëri.



Metodat aktive dhe ndëraktive për veprimtaritë e luftës kundër trafikimit

- **Leximi i orientuar**, i cili shpesh përdoret për të stimuluar mendimet e nxënësve nëpërmjet leximit të historive interesante. Këto histori lidhen me shprehjet e tyre të lira, të cilat pasi zgjidhen mbi bazën e disa ideve, janë një pikë e mirë për diskutime në klasë.
- **Rrethi**. Në këtë teknikë nxënësit ulen në pozicione të barabarta gjatë diskutimeve, pavarësisht nga seksi, ngjyra, besimi, raca apo ndonjë vështirësi mendore apo fizike e tyre. Në rreth ata diskutojnë lirisht. Kjo teknikë përdoret gjatë prezantimit të tyre (çdo fëmijë ka të drejtën për të pasur një emër). Fëmijët thone emrin e tyre shkurtimisht, por ndonjëherë kjo bëhet me lëvizje të dikujt dhe emri krahasohet me objekte, sende apo personazhe nga librat, apo personazhe të tjerë nga jeta reale që ata i duan vërtetë.
- **Konferencat e shtypit**. Kjo metodë përdoret gjatë detyrave me shkrim ku nxënësit prezantojnë shkurtimisht idetë e tyre, përmbajtjen dhe strukturën e materialit të shkruar. Pas kësaj, ata i përgjigjen të gjitha pyetjeve të bëra nga shokët e tyre lidhur me materialin e shkruar. Në këtë rast, nxënësit edukohen me respektin për opinionet dhe idetë e të tjerëve dhe mësohen t'i dëgjojnë me kujdes këto opinione. Gjatë këtyre situatave janë interesante refleksionet e opinioneve të nxënësve, të cilat ndonjëse fokusohen mbi temën, janë shumë të ndryshme pasi shprehen nga këndvështrime të ndryshme. Kjo bën të mundur një proces të menduarit kritik të nxënësve.
- **Cinquain** është një metodë tjetër, e cila i jep mundësi nxënësve të sintetizojnë njohuritë që kanë për të drejtat e njeriut dhe t'i paraqesin ato në formën e një poeme. Zakonisht, nëpërmjet kësaj teknike, prezantohen të drejtat për një mjedis të pastër, të drejtat e familjes, të shkollimit etj. Nxënësit shkruajnë vargje apo poema për këto të drejta. Nëpërmjet këtyre poemave ata shprehin idetë e tyre, duke u mbështetur sigurisht në rregullat e poezisë.
- **Leximet suplementare**. Kjo metodë zbatohet gjatë leximit të historive, të cilat lidhen me të drejtat dhe në mënyrë të veçantë me ato detyra dhe përgjegjësi që gjenden në përmbajtjen e librit që lexohet. Shenjat ($\sqrt{\text{dhe -}}$) përdoren nga nxënësit për identifikimin e tyre. Në fund të leximit, ata diskutojnë me njëri tjetrin ose në grupe lidhur me të drejtat dhe përgjegjësitë që ju takojnë atyre.
- **Tabela e koncepteve**. Kjo teknikë përdoret në ato aktivitete që identifikojnë detyrat dhe përgjegjësitë në raport me të drejtat e paraqitura në materialin që lexohet.
- **Diagrami Venn** është një teknikë e përdorur shpesh në shumë veprimtari që lidhen me të drejtat e njeriut, në mënyrë të veçantë në rastet kur ka konflikt midis këtyre të drejtave. Procesi i identifikimit të të drejtave që janë në konflikt përcaktohet lehtësisht nga ndërprerja e diagrameve.
- **Drama** Metoda e saj ndëraktive mund të përdoret nga nxënësit. Çdo student do të ketë pjesën e tij/saj të dramës dhe do ta mësojë atë paraprakisht. Këto pjesë duhet të shkruhen nga autori dhe është autori ai që zgjedh rolet. Pas këtij procesi studentët do t'i luajnë rolet të gjithë së bashku duke përdorur lëvizjet, gjestet teatrale dhe zërat elastik sipas pjesëve përkatëse. Kur drama mbaron së shfaquri, mësuesi dhe studentët mund të bëjnë një analizë të përmbajtjes së dramës, personazheve dhe lojës së aktorëve. Në letërsi apo histori, edukatë morale, mësuesit mund të gjejnë drama të shkurtra që lidhen me çështjet e të drejtave të njeriut dhe trafikimit të qenieve njerëzore.

- **Intervista** përdoret kur nxënësit pyesin njeri tjetrin (punojnë në dyshe apo në grupe). Pyetjet janë momentale apo të përgatitura që më parë. Ato kanë të bëjnë me konceptet e ndryshme të nxënësve për të drejtat e njeriut dhe trafikimin e qenieve njerëzore.
- **Harta e të menduarit** është një metodë pedagogjike interaktive që mund të përdoret nga mësuesit gjatë procesit të të mësuarit dhe mësimit. Mësuesit duhet të shkruajnë në tabela grafike të gjitha përgjigjet e studentëve, duke i përzgjedhur dhe grupuar ato në përputhje me temën në diskutim e sipër. Kjo metodë përfshin nxitjen e ideve dhe procesin e grupimit të përgjigjeve të pjesëmarrësve në tabela grafike.
- **Interpretimi i roleve** jo është një metodë e ngjashme me dramën, por në këtë rast rolet mund të zgjidhen dhe të krijohen nga studentët. Çdo student mund të zgjedh një rol. Ata mund të krijojnë role të lidhura me të drejtat e njeriut, shkollimin dhe mund t'i luajnë këto role në klasë. Mësuesit duhet t'i drejtojnë këto veprimtari dhe pas mbarimit të pjesës mund të organizojnë diskutime dhe debate rreth përmbajtjes së saj dhe interpretimit të roleve.

Duke i parë me kujdes përgjigjet e nxënësve shohim se ato paraqesin një mendim të thellë, interpretime të ndryshme që mundësojnë mendimin kritik.

Këto ishin disa prej strategjive, metodave dhe teknikave që parashtruan. Por ka edhe shumë të tjera që përdoren gjatë veprimtarive që lidhen me të drejtat e njeriut. Ato lidhen me njëra tjetrën nëpërmjet ndërveprimit, i cili është edhe koncepti i tyre bazë. Kjo shfaqet gjatë bashkëpunimit të nxënësve me njëri tjetrin, gjatë punës së tyre në grupe, në ambientin fizik, fleksibël dhe lehtësisht të menaxhueshëm të klasës, me prindërit dhe mësuesit e tyre, të cilët shpesh marrin pjesë në këto veprimtari.

Shkollat që kanë punuar në këtë fushë reflektojnë këta tregues:

- *Programet mësimore u pasuruan me veprimtari të lidhura me të drejtat e njeriut dhe demokracinë.*
- *Shkolla ishte e hapur për bashkëpunim mes mësuesve, nxënësve dhe prindërve.*
- *Prindërit preferonin këtë shkollë për fëmijët e tyre.*
- *Nxënësit demonstuan kapacitete më të fuqishme në zgjidhjen e konflikteve.*
- *Nxënësit demonstuan angazhim të lartë në procesin e të mësuarit.*
- *Nxënësit njohën dhe pranuan detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në shkollë, shtëpi dhe shoqëri.*

Së fundi, dua të theksoj se metodologjia e të drejtave të njeriut dhe çështjeve të trafikimit të qenieve njerëzore ka patur ndikimin e vet jo vetëm mbi procesin mësimor, por edhe në pasurimin e programeve mësimore me elemente stimulus për nxënësit e nivelit arsimor fillestar dhe sekondar.

***Ky material është përgatitur nga Robert Gjedia dhe mund të gjendet në faqen e internetit:**
<http://www.hrea.org>



Përfshirja e Veprimtarive të Luftës kundër Trafikimit në Programet Mësimore

1. Gjuha dhe Letërsia

Shumë vepra artistike, nga përrallat dhe gjëgjëzat deri te proverbat dhe proza (novelat dhe romanet), adresojnë konfliktet e jetës nëpërmjet përmbajtjes dhe subjektit së tyre. Këto konflikte mund të përfshijnë apo të kenë lidhje me çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore dhe të drejtave të njeriut.

Cilat vepra artistike që studiohen në programet mësimore standarde adresojnë çështje që mund të lidhen me trafikimin, emigrimin, punën e fëmijëve, dhunën në familje etj? Për këtë qëllim mund të shërbejnë edhe artikujt nëpër gazeta apo publikime të tjera të pavarura.

2. Historia and Gjeografia

Faktet, ngjarjet, vendet dhe datat historike shprehin përpjekjet e shoqërisë për të ndërtuar strukturat e saj shoqërore në përputhje me rregullat dhe ligjet, duke shprehur në përgjithësi të drejtat e njeriut dhe trafikimin e qenieve njerëzore.

Kurset e historisë ofrojnë një mundësi të mirë për të trajtuar çështjet që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore pasi vetë historia njerëzore është një përpjekje për të zbatuar të drejtat e njeriut. Koncepte të tjera si emigrimi mund të përfshihen në orët e gjeografisë. Çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore, të të drejtave të njeriut, të emigracionit, punës së fëmijëve dhe dhunës për shkak të gjinisë mund të lidhen me studimin e luftrave, lëvizjeve demokratike në vende të ndryshme, studimit të figurave të shquara historike dhe kulturave të vendeve të ndryshme. Të lidhura me studimin e historisë dhe gjeografisë janë edhe çështjet që lidhen me vendimmarrjen, të cilat mund të përdoren për nxitjen e mendimit të pavarur. Mësuesit mund t'i venë nxënësit që të analizojnë mënyrën se si figura të ndryshme historike kanë mundur të zgjidhin problemet, çfarë aftësish kanë përdorur, si e kanë marrë informacionin e nevojshëm.

3. Gjuhët e Huaja dhe Lëndët Shoqërore

Studimi i gjuhëve të huaja është një dritare për të mësuar rreth kulturave të tjera dhe një mundësi për t'u integruar me kultura të tjera. Zbatimi i standardeve të të drejtave të njeriut lidhet me respektin dhe kuptimin ndërkulturor. Mësuesit mund ta lidhin këtë ide me kulturat e pakicave brenda kulturës së vendit për të nxitur një kuptim më të mirë dhe për të ulur shkallën e diskriminimit që mund të çojë në trafikim dhe shfrytëzim.

Nëpërmjet studimit të gjuhëve të huaja ne mund të shohim edhe modelet e emigrimit nga dhe për në vendet që flasin këtë gjuhë. Po ashtu, mësuesit mund të zgjedhin lexime në gjuhë të huaja që lidhen me çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore, emigrimin, punën e fëmijëve, dhunën në familje apo për shkak të gjinisë etj. Pas leximit, nxënësit mund të zhvillojnë diskutime rreth këtyre çështjeve në gjuhë të huaj.

4. Biologjia dhe Shkencat e tjera

Lëndët e biologjisë, kimisë dhe edukatës shëndetësore merren me nevojat fizike të qenieve njerëzore për ujë, ushqim, kujdes dhe mbrojtje, dhe për një ambient të pastër. Shpesh, njerëzit privohen nga këto nevoja bazë gjatë trafikimit të qenieve njerëzore me qëllim shfrytëzimin e punës. Po ashtu, çështjet që lidhen me dhunën për shkak të gjinisë dhe dhunën seksuale mund të diskutohen gjatë studimit të riprodhimit në orën e biologjisë.



Taksonomia e Bloom

NIVELI	PERKUFIZIMI	FOLJET TIP	SJELLJET TIP
NJOHURITE	Studentët rikujtojnë ose njohin informacionin, idetë dhe parimet në formën e përafërt me të cilën i kanë mësuar	Shkruaj Rendis Etiketoj Emërtoj Pohoj Përkufizoj	Studentët do të përkufizojnë 6 nivelet e Taksonomisë së Bloom për fushën njohëse.
KUPTIMI	Studenti përkthen, kupton apo interpreton informacionin mbi bazën e asaj që ka mësuar më përpara	Shpjegoj Përmbledh Perifrazoj Përshkruaj Ilustroj	Studentët do të shpjegojnë qëllimin e Taksonomisë së Bloom për fushën njohëse
ZBATIMI	Studentët përzgjedhin, tranferojnë dhe përdorin të dhëna dhe parime për të zgjidhur një problem apo detyrë me një minimum orientimi	Përdor Njehsoj Zgjidh Demonstroj Zbatoj Ndërtoj	Studentët do të shkruajnë një objektivi udhëzues për çdo nivel të Taksonomisë së Bloom
ANALIZIMI	Studentët dallojnë, klasifikojnë dhe lidhin supozimet, hipotezat, të dhënat apo strukturën e një pohimi apo pyetje	Analizoj Kategorizoj Krahasoj Ballafaqoj Ndaj	Studentët do të krahasojnë dhe ballafaqojnë fushat njohëse dhe emocionale
VLERESIMI	Studentët vlerësojnë, gjykojnë apo kritikojnë mbi bazën e standardeve dhe kritereve specifike	Gjykoj Rekomandoj Kritikoj Justifikoj	Studentët do të gjykojnë efektshmërinë e shkrimit të objektivave duke përdorur Taksonominë e Bloom
SINTEZA	Studentët gjenerojnë, përfshijnë dhe kombinojnë idetë e tyre në një produkt, plan apo propozim që është i ri për ta	Krijoj Skicoj Hamendësoj Shpik Zhvilloj	Studentët do të skicojnë një skemë klasifikimi për të shkruar objektivat arsimor që kombinojnë fushat emocionale, njohëse dhe psikomotorre.



Një strukturë për Hartimin e Leksioneve për Luftën kundër Trafikimit

1. Lënda _____

2. Tema brenda Lëndës (nga programi ekzistues) _____

3. Qëllimi i Luftës kundër Trafikimit (cilat aspekte të parandalimit të trafikimit do të përfshihen brenda temës)

4. Objektivat (aftësitë që duhet të fitohen nga nxënësit & studentët nëpërmjet veprimtarive që realizojnë qëllimin e lartpërmendur – shih Fletëpalosjen 3 – Bloom's Taxonomy)

1. Njohuritë: _____

2. Kuptimi apo Zbatimi: _____

3. Analizimi, Vlerësimi, apo Sintezë: _____

4. Limiti Kohor: 20 minuta

5. Materialet e Nevojshme

6. Metodologjia e Përdorur

7. Hapat e Detajuara për arritjen e qëllimeve të veprimtarisë:



Faktorët që ndikojnë në procesin vendimmarrës të fëmijëve

(A) Vendimet që duhet të merren:.....

(B) Faktorët që ndikojnë në procesin vendimmarrës për këtë vendim:

1.
2.
3.
4.
5.
6.

(C) Ku mund të merret më shumë informacion në lidhje me marrjen e këtij vendimi:

Informacioni shtesë i nevojshëm

Ku mund të merret ky informacion

- | | |
|---------|-------|
| 1. | |
| 2. | |
| 3. | |
| 4. | |
| 5. | |
| 6. | |



Faleminderit për kohën që i kushtuat plotësimit të këtij pyetëso. Ju lutemi, jeni të lirë të shënoni më shumë se një përgjigje aty ku e gjykoni të nevojshme, si edhe të bëni komente. Opinione tuaja do të na ndihmojnë për të përmirësuar trainimin e ardhshëm. *Gjithë informacioni do të mbetet konfidencial.*

Informacion personal:

Gjinia	Mosha	Niveli arsimor
<input type="checkbox"/> Mashkull	<input type="checkbox"/> 18-25	<input type="checkbox"/> Fillestar
<input type="checkbox"/> Femër	<input type="checkbox"/> 26-40	<input type="checkbox"/> Sekondar
	<input type="checkbox"/> 41-55	<input type="checkbox"/> Arsim profesional
	<input type="checkbox"/> 56-65	<input type="checkbox"/> Niveli i arsimit profesional
	<input type="checkbox"/> 65+	<input type="checkbox"/> Diplomë universiteti
		<input type="checkbox"/> Master
		<input type="checkbox"/> Doktoraturë

Punësimi

- Mësues në shkollë të mesme
- Mësues në nivelin arsimor sekondar
- Mësues në nivelin arsimor fillestar
- Tjetër: _____

1) Cila përgjigje përfshin grupin e elementëve, të cilët duhet të jenë të pranishëm në mënyrë që një situatë e caktuar të kategorizohet si trafikim i qenieve njerëzore? **Zgjidhni vetëm një përgjigje**

- Emigrimi ndërkombëtar; prostituimi; detyrimi, mashtrimi apo abuzimi me pushtetin
- Emigrimi ndërkombëtar; shfrytëzimi; detyrimi, mashtrimi apo abuzimi me pushtetin
- Emigrimi ndërkombëtar; shfrytëzimi
- Rekrutimi/emigrimi i ndihmuar; shfrytëzimi; detyrimi, mashtrimi apo abuzimi me pushtetin
- Rekrutimi/emigrimi i ndihmuar; prostituimi; detyrimi, mashtrimi apo abuzimi me pushtetin
- Emigrimi i paligjshëm; prostituimi; detyrimi, mashtrimi apo abuzimi me pushtetin
- Emigrimi i paligjshëm; shfrytëzimi; detyrimi, mashtrimi apo abuzimi me pushtetin
- Emigrimi i paligjshëm; shfrytëzimi

2) Cili prej pohimeve të mëposhtme e përshkruan më mire ndryshimin midis trafikimit të qenieve njerëzore dhe kontrabandës së emigrantëve? **Zgjidhni vetëm një përgjigje**

- Trafikimi dhe kontrabanda janë e njëjta gjë.
 - Kontrabanda përfshin ndihmën për të hyrë ilegalisht në një Shtet të caktuar. Trafikimi mund ose mund të mos e përfshijë hyrjen ilegale në një Shtet të caktuar, por rezulton edhe në shfrytëzim seksual ose në shfrytëzim të punës nëpërmjet forces, mashtrimit ose abuzimit me pushtetin.
 - Kontrabanda përfshin detyrimin e njerëzve për të punuar në kushte shfrytëzuese në vende të huaja. Trafikimi përfshin detyrimin e grave për të punuar si prostituta në vende të huaja.
- 3) A mendoni se vendi juaj është i prekur nga trafikimi i qenieve njerëzore?
- Po, së tepërmi
 - Në njëfarë mase
 - Aspak
 - Nuk e di
- 4) A mendoni që shkolla luan një rol në parandalimin e trafikimit?
- Po
 - Jo
- 5) Nëse po, ju lutemi përshkruani rolin që luan shkolla në parandalimin e trafikimit
- 6) A mund të përfshihet parandalimi i trafikimit në lëndët që jepni mësim?
- Po
 - Jo
- 7) Nëse po, ju lutemi përshkruani shkurtimisht mënyrën e përfshirjes së parandalimit të trafikimit në lëndën që jepni mësim.

Pyetje lidhur me studimin e rasteve:

- 8) Daniela është një vajzë 14 vjeçare të cilën halla/tezja e ka dërguar për të punuar gjatë verës në një fabrikë në një shtet të huaj. Ajo merr pagesat për punën që kryen Daniela nga burri që e ka rekrutuar atë dhe Daniela është e lumtur që ndihmon familjen. A është Daniela viktimë e trafikimit?
- Po
 - Jo

Shpjegoni përsenë për secilën nga përgjigjet:

- 9) Pa ndihmën e askujt, Andrew hyri ilegalisht në një shtet tjetër për të punuar në ndërtim. Puna është shumë e rrezikshme, kushtet e jetesës janë shumë të këqija dhe ai në më të shumtën e rasteve punon 15 orë në ditë dhe paguhet shumë pak. Ndonëse

Andrew nuk është i lumtur, ai vendos të qëndrojë pasi fiton më tepër nga sa mund të fitonte në vendin e tij. A është Andrew i trafikuar apo i kontrabanduar?

- I Kontrabanduar
- I trafikuar
- Të dyja së bashku
- Asnjëra

Ju lutemi, shpjegoni përgjigjen tuaj:

10) Maria vendosi të pranonte të punonte si prostitutë në një shtet tjetër. Ajo hyri në atë shtet nëpërmjet kontrabandës dhe më pas u detyrua të punonte nën kërcënimin për dhunë. Asaj ju muarën të gjitha dokumentet dhe të gjitha të ardhurat i kalonin punëdhënësit të saj? A është Maria viktimë e trafikimit?

- Po
- Jo

Shpjegoni përsenë për secilën nga përgjigjet:

11) Jacob vendosi ta linte shtëpinë për të kërkuar punë pasi kishte shqetësimin se nuk fitonte para të mjaftueshme për të paguar shkollimin e fëmijëve të tij. Një burrë nga qyteti ku jetonte i ofroi ndihmë për ta futur ilegalisht në një shtet tjetër. Sapo kaloi kufirin, ai gjeti punë në një fabrikë aty pranë. Pasi disa javësh, një burrë me të cilin punonte i foli Jacob për një punë më të mire në qytet. Jacob i dha këtij burri të gjitha kursimet e tij dhe një natë ata udhëtuan me kamion për në një fabrikë që ishte e lidhur me fjetoren ku do të jetonte Jacob. Pasi u takua me punëdhënësin, Jacob i dorëzoi këtij të fundit të gjitha dokumentet e udhëtimit në mënyrë që ata t'i jepnin lejen e punës. Atij i thanë se punëdhënësi do t'i zbriste nga rroga shpenzimet e qëndrimit dhe ushqimit. Kur Jacob u përpoq të dilte jashtë një mbrëmje për të gjetur një telefon për të njoftuar familjen se ai ishte mire, një burrë me armë në dorë i tha se punëtorët nuk lejoheshin të dilnin. Atë e kërcënuan se do ta kthenin në vendin e tij dhe se familja e tij mund të dëmtohej nëse ai shkaktonte ndonjë shqetësim. A ishte Jacob i kontrabanduar, trafikuar apo të dyja së bashku?

- I kontrabanduar
- I trafikuar
- Të dyja së bashku
- Asnjëra

Ju lutemi, shpjegoni përgjigjen tuaj:

Faleminderit! Ne e vlerësojmë pjesëmarrjen tuaj!



Vlerësimi i IOM mbi Trainimin për Luftën kundër Trafikimit

Data dhe vendi i trainimit _____

1. Cila prej pjesëve të këtij trainimi ju shërbeu më shumë?

2. Çfarë mund ta kishte bërë këtë trainim edhe më të dobishëm?

3. Çfarë do të ndryshojë në mësimdhënien tuaj si rezultat i pjesëmarrjes në këtë kurs?

4. Cila ishte përshtypja juaj e përgjithshme për trainimin?

1 2 3 4 5
pak i vlefshëm shumë i vlefshëm

5. Sugjeroni temat për të cilat do të kishit interes që të diskutoheshin në trainimet e ardhshme

6. Ju lutemi, bëni çfarëdolloj komenti lidhur me këtë trainim, moderatorët apo trainuesit.

Faleminderit!